

# VLERËSIMI I REINTEGRIMIT TË PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE RIVITALIZIMI I RAJONEVE TË GODITURA NGA KONFLIKTI NË MAQEDONI

Tetor 2003

„E tërë ndihma sikur ta kishte kapërcyer fshatin tonë – anipse edhe ne përdorëm armë...”

Manuel Rast, FAKT  
Ralf Lange, FAKT  
Aleksandar Kërzhlovski, QMBN  
Visar Ademi  
Zoran Kostov

## P ë r m b a j t j a

### 1. REZYME

- 1.1. Informata themelore
- 1.2. Rezume për konstatimet dhe përfundimet
  - 1.2.1. Riintegrimi
  - 1.2.2. Rivitalizimi
  - 1.2.3. Rekomandime kyçe

### 2. HYRJA

- 2.1. Informata themelore dhe synimet e studimit
- 2.2. Metodologjia e studimit

### 3. KRIZA NË MAQEDONI, KONTEKSTI I SAJ DHE PASOJAT

- 3.1. Konteksti
  - 3.1.1. Rrënjët e konfliktit
  - 3.1.2. Marrëveshja kornizë (e Ohrit)
  - 3.1.3. Situata momentale
- 3.2. Efektet sociale: shpërngulja dhe kthimi
- 3.3. Kriza dhe pasojat socio-ekonomike të saj

### 4. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI I PERSONAVE TË SHPËRNGULUR BRENDA VENDIT DHE REFUGJATËT

- 4.1. Situata momentale e kthimit
- 4.2. Masat për rehabilitimin dhe rindërtimin
  - 4.2.1. Strehimi
  - 4.2.2. Infrastruktura
  - 4.2.3. Hapësira komerciale
  - 4.2.4. Masat për ndërtimin e besimit
- 4.3. Riintegrimi
  - 4.3.1. Faktorët socio-etnikë
  - 4.3.2. Faktorët e sigurimit
  - 4.3.3. Faktorët ekonomikë

- 4.3.4. Gratë /gjinitë
- 4.3.5. Aspektet e të rinjve

## 5. RIVITALIZIMI I RAJONEVE TË GODITUTA NGA KONFLIKTI

- 5.1. Përparimi i arritur në rivitalizimin ekonomik
  - 5.1.1. Arritja e përparimit të përgjithshëm dhe roli i Qeverisë dhe i donatorëve
  - 5.1.2. Përparim i arritur në nivel të bashkësisë, roli i sektorit privat
- 5.2. Gjendja socio-ekonomike në rajonet e krizës
  - 5.2.1. Kriza me papunësinë
  - 5.2.2. Strategjia e përballjes
  - 5.2.3. Efektet e transformimit ekonomik në jetesën e njerëzve
- 5.3. Potenciali i rivitalizimit
- 5.4. Qasja e rivitalizimit

## 6. REKOMANDIME

- 6.1. Rekomandime të përgjithshme
  - 6.2. Rekomandime për kthimin dhe riintegrimin
  - 6.3. Rekomandime për rivitalizimin ekonomik
- Shtojca 1: Rezyeme
- Shtojca 2: Pasqyra e vlerësimeve dhe e personave kyç të intervistuar
- Shtojca 3: Analiza e të dhënave. Rrjedha e personave të shpërngulur brenda vendit / refugjatët
- Shtojca 4: Pasqyra e infrastrukturës dhe rikonstruksionit të shtëpive
- Shtojca 5: Të dhënat ekonomike dhe informatat themelore
- Shtojca 6: Të dhënat socio-ekonomike
- Shtojca 7: Studimi i rasteve
- Arnaqi
  - Novo Sellë
  - Sllupçan
  - Jegunovcë
  - Tearcë
- Shtojca 8: Strategjia e donatorëve për rivitalizimin
- Shtojca 9: Koncepti për rivitalizimin
- Shtojca 10: Pasqyra: Kriza e Maqedonisë dhe pasojat e saj

### Shkurticat

CBI-Capacity Building Initiative (Iniciativa për Ndërtimin e Besimit)  
CBO-Community based Organisation (Organizata e Mbështetur te Bashkësia)  
ESA-Enterprise Support Agency (Agjencia për Përkrahjen e Ndërmarrjeve)  
ESI-European Stability Initiative (Iniciativa Evropiane për Stabilitet)  
FRY-Federal Republic of Yugoslavia (Republika Federale e Jugosllavisë)  
IDP-Internally Displaced People (Persona të shpërngulur brenda vendit)  
IMF-International Monetary Fund (Fondi Ndërkombëtar Monetar)  
IMG-International Management Group (Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit)  
IOM-International Organisation for Migration (Organizata Ndërkombëtare e Shpërnguljes)  
MCIC-Macedonian Center for International Cooperation (Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar)

MEDF-Macedonian Enterprise Development Foundation (Fondacioni Zhvillimor Maqedonas për Ndërmarrje)  
USAID-US Agency for International Development (Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar)  
UNHCR-United National High Commissioner for Refugees (Komesariati i Lartë për Refugjatë pranë Kombeve të Bashkuara)  
UNDP-United National Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)  
OTI USAID-Oficce for Transition Initiatives (Zyra për Iniciativa Tranzicioni)  
RNE-Toyal Netherlands Embassy (Ambasada e Mbretërisë së Holandës)  
SME-Small and Medium sinzed Enterprises (Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme)  
WTO-World Trade Organitation (Organizata Botërore e Tregtisë)

## 1. REZYME

### 1.1. Informata themelore

Kaluan dy vjet nga konflikti, i cili Maqedoninë e solli buzë luftës qytetare. Edhe pse është bërë mjaft në aspektin e ofrimit të ndihmës, ndjehet se rajonet e mëparshme të krizës, si dhe pjesa tjetër e vendit, nuk janë këndellur ende, dhe se, gjendja në shoqëri, në përgjithësi, ende është e ndjeshme.

Duke pasë parasysh këtë fakt, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN), organizatë joqeveritare, joprofitabile, e themeluar në vitin 1993, e cila është aktive në planin e zhvillimit, rehabilitimit dhe ndihmës, bashkë me Ambasadën e Mbretërisë së Holandës, vendosi të hartojë një studim gjithëpërfshirës me qëllim që ta vlerësojë përparimin e arritur në fushën e riintegrit të personave të shpërngulur brenda vendit dhe refugjatët, të cilët i braktisën shtëpitë e tyre gjatë kohës së krizës më 2001, ta vlerësojë përparimin në planin e rivitalizimit të rajoneve të goditura nga konflikti, dhe, më në fund, të sigurojë rekomandime për kompletimin, ose, të paktën, për intensifikimin e këtyre proceseve.

Studimi është përgatitur si punë e përbashkët e QMBN dhe FAKT-it, firmë konsulente, joprofitabile me seli në Gjermani dhe me konsulentë vendorë. Faza e parë e cila mirret me grumbullimin dhe analizën e të dhënave dytësore, zhvillohej nga gushti i vitit 2003, ndërsa puna në terren – faza e dytë – qe realizuar nga 22 shtatori deri më 6 tetor.

### 1.2. Rezyme e konstatimeve dhe përfundimeve

#### 1.2.1. Riintegrimi

Edhe pse 95% të të shpërngulurve të brendshëm dhe të refugjatëve, u kthyen në shtëpitë e tyre, dhe se kjo çështje konsiderohet gati e zgjidhur, gjendja ende nuk është e kënaqshme, duke marrë parasysh faktin se të shpërngulurit e pakënaqur brenda vendit, ende tërheqin vëmendje të madhe të mediave dhe mund të paraqesin kërcënim për situatën politike delikate.

Rikonstruksioni, i cili qe fokusuar kryesisht në shtëpitë private, pritet të përfundojë brenda disa muajve. Edhe përkundër të arriturave të rëndësishme, një numër i madh fshatarësh nuk janë të kënaqur, një pjesë për shkak se

kanë pritur shumë më tepër, kurse pjesa tjetër për shkak të mungesës së transparencës.

Infrastruktura publike në rajonet ku zhvilloheshin konfliktet, kryesisht është në gjendje të mjerueshme dhe kërkon kujdes të posaçëm. Kjo vlen edhe për ish rajonet e krizës, si dhe viset përreth. Fondet eksiztuuese nuk do ta zgjidhin problemin, kurse bashkësitë lokale kanë nevojë për një kapacitet për planifikim dhe implementim të përgjegjshëm.

Gjendja e sigurisë është përmirësuar dukshëm edhe përkundër incidenteve që ndodhin, të cilat, sipas të gjitha gjasave janë të natyrës kriminale, por, gjithashtu, edhe për shkak të qarkullimit të sasisë së madhe të armëve.

Forcat policore, në radhët e veta integruan edhe shqiptarë etnikë, dhe me këtë e rritën kredibilitetin e tyre në mesin e pakicës shqiptare.

Marrëdhëniet ndëretnike, në masë të madhe, kanë pësuar gjatë dhe pas konfliktit, dhe, derisa shqiptarët etnikë ende ndjehen të padrejtësuar, maqedonasit etnikë gjithnjë e më tepër ndjehen të kërcënuar.

Janë zhvilluar aktivitete të shumëta për ndërtimin e besimit. Edhe pse është vështirë të matet ndikimi i tyre, këto aktivitete duhet vazhduar me çdo kusht, bile edhe në nivel më të lartë. Ato duhet të integrohen në jetën sociale, kurse shembujt pozitivë kërkojnë publicitet.

### 1.2.2. Rivitalizimi

Është qëndrim i pranueshëm i bashkësive konkrete, Qeverisë dhe organizatave joqeveritare, se rivitalizimi i jetës rurale dhe i ekonomisë lokale, nuk e kishte kujdesin e merituar të opinionit. Fokusi i Qeverisë dhe i donatorëve ishte orientuar kah ndihma dhe rikonstruksioni i shtëpive, dhe shumë më pak kah rindërtimi i ekonomisë. Faktori kyç për procesin e ngadalshëm të këndelljes së ekonomisë ishte ekonomia e dobët e shtetit. Kriza e sigurisë më 2001, kishte ndikim negativ në procesin e këndelljes nacionale, dhe i lëkundti shpresat e një pjese të madhe të qytetarëve të Maqedonisë se, kushtet e jetesës do t'u përmirësohen, kurse papunësia dhe varfëria paraqesin edhe një arsye më tepër për pesimizëm.

Në mikro nivel, ka shumë shenja të këndelljes ekonomike. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në lëmin e tregtisë, shërbimeve dhe ndërtimit, në shumicën e rasteve, qenë rehabilituar pa ndihmën e institucioneve.

Në një masë të madhe besohet se “kapaciteti për autondihmë”, sidomos te popullata shqiptare, e cila përkrahet përmes lidhjeve të ngushta familjare dhe dërgimit të të hollave nga anëtarët e familjeve që jetojnë jashtë shtetit, ishte faktor vendimtar i procesit të këndelljes. Projektet për ndikim të shpejtë, mbase kanë pasur farë ndikimi pozitiv. Megjithatë, grupet etnike që janë pakicë në bashkësitë e tyre përballen me shumë pengesa në rindërtimin e jetës dhe të biznesit të tyre.

Papunësia është arsyeja kryesore e shqetësimit të të gjitha grupeve etnike, të cilat jetojnë në rajonet e goditura nga konfliktet, siç është edhe për maqedonasit shumicë. Pasiguria në lidhje me zhvillimin politik të ngjarjeve, është pengesa kryesore për investime. Këndellja ekonomike, veçanërisht është e ngadalshme atje ku rrisqet politike dhe të sigurisë janë të mëdha, dhe atje ku të ardhurat, kryesisht burojnë nga bujqësia, siç është rasti me Sllupçanin dhe me fshatrat e tjerë të rajonit më të gjerë të Kumanovës.

Ekipi ka ardhur në përfundim se rivitalizimi nuk duhet të lihet vetëm në fuqitë tregtare. Qeveria duhet të zhvillojë një strategji kohezive dhe atë ta bëjë publike. Kjo strategji do të duhet të bartet edhe në proceset për zhvillim lokal, dhe gjatë kësaj në mënyrë aktive të kyçet administrata lokale dhe bashkësia e biznesit. Rivitalizimi ekonomik duhet të bashkërenditet me zhvillimin e infrastrukturës dhe me përmirësimin e shërbimeve elementare sociale, sidomos me arsimimin e përmirësuar dhe me trajnimin teknik. Kujdes i veçantë duhet kushtuar sektorit bujqësor.

### 1.2.3. Rekomandime kyçe

Ndihma për rikonstrukcion dhe rivitalizim ende është e nevojshme në pjesën veriperëndimore të vendit. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar fshatrave, të cilat deri tani janë lënë pas dore, sidomos të atyre që u përcaktuan për paqe, në vend se të kyçeshin në konflikt. Qasjet integruese, dhe qasjet e mbështetura tek masat për tërë rajonin, kanë përparësi karshi masave të izoluar. Ka nevojë për një gërshetim të subjekteve dhe koordinim më të mirë në nivel lokal.

Qeveria duhet të ndërmarrë rol koordinues me agjencitë dhe të jetë më e pranishme te bashkësitë. Qeverisjes lokale duhet t'i jepen injerenga për të pasur rol në zhvillimin ekonomik. Tensionet midis grupeve etnike duhet të zgjidhen me konceptin e integritit dhe të jenë në pajtim me Marrëveshjen Kornizë, si dhe t'i pengojnë tendencat për ndarjet e mëtejshme në shoqëri. Edhe pse gjendja vlerësohet si e ndjeshme, por stabile, ende ka grupe që mund ta destabilizojnë gjendjen. Në krahasim me lufërat e tjera qytetare, në Maqedoni nuk është bërë shumë për pajtimin e shoqërisë. Duhet programe për pajtim, me aktivitete konkrete të grupeve të specializuara, si ish luftëtarët, të shpërngulurit e brendshëm dhe refugjatët. Vetëdija publike është faktor relevant për pengimin e manipulimeve që i promovojnë disa politikanë dhe grupe të vogla të interesit. Të nevojshme janë edhe fushatat publike, si dhe programet lidhur me mediumet si dhe me ata që e formojnë opinionin publik. OJQ-të duhet ta kenë rolin kryesor në implementimin e këtyre programeve.

Rivitalizimi i sektorit bujqësor duhet të ketë prioritet. Kjo nënkupton masat për kyçjen e rehabilitimit të firmave familjare dhe, në nivel komercial, edhe të promovimit të nënsektorëve me potencial zhvillimi. Masat duhet të ndërmirren me urgjencë dhe të përmirësohet qasja e biznesmenëve të shërbimet financiare, psh. përmes krijimit të fondeve grante. Ka nevojë edhe për lobim për t'u përmirësuar kujdesi i Qeverisë. Biznesët duhet të kenë rol në përforcimin e marrëdhënieve ndëretnike, psh., përmes promovimit të lidhjeve afariste ndëretnike dhe të ndërmarrjeve afariste me përbërje të përzier etnike.

## 2. HYRJA

### 2.1. Informata themelore dhe synimet e studimit.

Kaluan dy vjet nga konflikti, i cili Maqedoninë e solli buzë luftës civile. Edhe pse është bërë shumë në planin e ofrimit të ndihmës, QMBN dhe Ambasada e Mbretërisë së Holandës, vendosën të hartojnë një studim gjithëpërfshirës për mënyrën si duhet të promovohet rivitalizimi socio-ekonomik i rajoneve të ish konfliktit.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar, është orgaizatë joqeveritare dhe joprofitabile, e themeluar në vitin 1993, e cila është aktive në planin e zhvillimit – gjegjësisht të promovimit të paqes, zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë civile, si dhe për ndihma grupeve në Maqedoni, të cilat kanë nevojë për të. Gjatë vitit 2001 dhe pas tij, QMBN, u kyç në mënyrë aktive në ndihmën urgjente dhe në rehabilitim.

Holanda, e përfaqësuar përmes Ambasadës së Mbretërisë të Holandës në Shkup, e cila zë vendin e tretë në mesin e donatorëve të mëdhenj në Maqedoni, pas UE dhe SHBA-ve, dëshiron ta rifokusojë vëmendjen e saj. Së bashku me QMBN, në pranverën e vitit 2003, vendosën të realizojnë një studim gjithëpërfshirës për ta vlerësuar zhvillimin e deritanishëm, në këta sektorë:

- a) Riintegrimi i personave të shpërngulur brenda vendit dhe i refugjatëve, të cilët i braktisën shtëpitë e tyre gjatë kohës së krizës më 2001,
- b) Rivitalizimi i rajoneve të goditura nga konfliktet, si dhe viseve përreth

Qëllimi primar ishte që të shihet përparimi në procesin e deritanishëm, të identifikohen mangësitë dhe të sygjerohen aktivitete për t'u kompletuar ose intensifikuar procesi i kthimit dhe i rivitalizimit (për informata më të hollësishme shih rezymenë e ToP në Shtesën 1).

Për implementimin e vlerësimit, QMBN dhe FAKT – Konsalt, firmë konsulente joprofitabile me seli në Gjermani, si dhe me dy konsulentë të nacionalitetit maqedonas, kishte angazhuar edhe një përfaqësues të lartë të QMBN, si dhe facilitatorë për diskutime grupore. Studimi që zhvilluar në dy faza. Faza e parë, për të cilën përgjegjëse është QMBN, zhvillohej nga korriku deri në gusht të vitit 2003. Faza e dytë, e facilituar nga FAKT, që realizuar nga 22 gushti deri më 6 tetor 2003. Anëtarë të ekipit, të cilët e realizuan studimin janë: Manuel Rast (FAKT), Ralf Lange (FAKT), Aleksandar Kërzhhalovski (QMBN), Visar Ademi dhe Zoran Kostov.

### 2.2. Metodologjia e studimit

Duke marrë parasysh ndërlikueshmërinë e detyrës, kohën e kufizuar në disponim dhe numrin e madh të informatave që mund të përdreshin në lidhje me këtë çështje, gjatë studimit qenë përdorur metodologjitë vijuese:

\* Grumbullimi dhe analiza e fakteve dytësore (kryesisht informata sasiore)

- \* Shqyrtimi i literaturës për analiza të kontekstit
- \* Realizimi i intervistave me informatorë kyç
- \* Realizimi i studimit të rasteve në fshatrat e goditur drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të tërthortë me përdorimin e metodave, siç janë:
  - Diskutimi grupor, me shfrytëzimin e formave të pranuar të analizave SWAT, si instrumente të anketave
  - Intervistat gjysmëstrukturore
  - Intervistat e pastrukturuara, rrëfim përralle

Për përzgjedhjen e fshatrave, për studimin e rastit, janë shfrytëzuar kriteret vijuese:

- \* Përzgjedhja e fshatrave në rajonet e krizës, si dhe fshatrat fqinj, ku s'ka pasur dëme
- \* Përzgjedhja e fshatrave me strukturë shumënacionale, si dhe fshatra njënacionale
- \* Të paktën të përfshihet një fshat, ku personat e shpërngulur brenda vendit nuk janë kthyer të gjithë.
- \* QMBN ka qasje /përvojë pune me OBQ/ OJQ, të cilat punojnë në atë lokalitet

Faza e parë përqëndrohet në grumbullimin dhe analizën e fakteve të tërthorta. Rezultatet janë dokumentuar në shtesat 3-5.

Faza e dytë ka tri synime:

- a) Plotësimin e fakteve të mbledhura në mënyrë indirekte me informata nga dora e parë prej trupave kyç të Qeverisë, dhe të agjencive të inkuadruara në procesin e rindërtimit
- b) Sigurimi i informatave autentike nga fshatrat e goditura nga kriza (studime dhe raste)
- c) Formulimi i përfundimeve dhe formulimi i rekomandimeve

Përfundimet kryesore dhe rekomandimet janë bërë me marrëveshje dhe janë formuluar së bashku nga ana e ekipit, i cili e realizonte studimin gjatë dy ditëve të fundit të periudhës të paraparë për të bërë studimin.

Pasqyra e fakteve dytësore zbuloi disa mangësi, për shkak se ishte vështirë të përkrahen disa përfundime me të dhëna të verifikuara. Të dhënat statistikore për papunësinë dhe varfërinë, psh., nuk dallojnë në mes të viseve të goditura dhe atyre që nuk janë goditur gjatë konfliktit. Komunitat shpeshherë japin informata jo të plota. Vlerësime për dëmin e subjekteve ekonomike nuk mund të gjenden, me çka vështirësohet verifikimi i informatave të vjelura nga fshatarët.

### 3. KRIZA NË MAQEDONI, KONTEKSTI I SAJ DHE PASOJAT

#### 3.1. Konteksti

Republika e Maqedonisë kalonte nëpër tranzicionin politik dhe ekonomik, në rrethana, të cilat ishin jo të zakonshme për vendet e Evropës Lindore dhe Qendrore. Demokracia politike e Maqedonisë, dhe pavarësia e saj, ndodhën brenda një periudhe kohore të shkurtë (1990-1999). Që të dy proceset ishin nën ndikimin e krizave të ish republikave të Jugosllavisë, por Maqedonia ia

doli ta ruajë stabilitetin e saj deri në vitin 2001. Për fat të keq, luftërat në Kroaci dhe Bosnjë, embargoja greke, sanksionet që OKB ia vuri Serbisë, si dhe Kriza e Kosovës, e dobësuan stabilitetin politik dhe ekonomik të Maqedonisë. Duke u ndeshur me presionin e jashtëm dhe në pamundësi që të fokusohet tek reformat e saja të brendshme politike dhe ekonomike, Maqedonia u ballafaqua me krizën ndëretnike në vitin 2001. Konflikti i armatosur prej tetë muajsh më 2001, përfundoi me të ashtuquajturën Marrëveshje Kornizë (të Ohrit), e cila mundësoi një mjedis ndryshe shoqëror dhe ekonomik në vend.

### 3.1.1. Rrënjët e konfliktit

Siç është rasti edhe me shumë çështje të tjera në Ballkan, ekzistojnë mendime të kundërta për natyrën e konfliktit, nga këndvështrimi se, ai ishte një konflikt klasik ndëretnik, deri tek mendimi se fjala është për konflikt të kurdisur, i shkaktuar nga përzierja e interesave kriminale dhe etno-nacionaliste të të dy palëve. Konflikti brenda shtetit, gjithashtu, përmbante elementë të fuqishëm të sulmit të jashtëm në raport me shkaktimin dhe të lojalitetin.

Hulumtime të tjera të konfliktit në Maqedoni (shih shtesën 10), flasin për disa aspekte të tjera, të cilat nuk tërhoqën vëmendjen e mjaftueshme të politikanëve maqedonas dhe perëndimorë. Psh., në ekonominë dhe shoqërinë e Maqedonisë janë identifikuar mangësi, të cilat e bëjnë vendin të anojë kah konfliktet etnike, duke theksuar trekëndëshin e problemeve, që janë në themelet e konfliktit të Maqedonisë: moszhvillimi i viseve rurale, dekapitalizimi permanent dhe paaftësia e institucioneve publike të Maqedonisë për t'u përballur me problemet në shoqëri.

Megjithatë, shpjegimi më i shpeshtë, i pranuar më së shumti edhe nga bashkësia ndërkombëtare, është se, me të vërtetë ezksitonte nevoja për përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe ato etnike të shqiptarëve në Maqedoni, në planin e Kushtetutës, të nënshtetësisë, gjuhës dhe arsimimit, pa marrë parasysh faktin se shqiptarët etnikë dhe partitë e tyre politike, janë pjesë e sistemit politik të Maqedonisë gjatë të gjithë periudhës së demokracisë (1990-2003), duke përfshirë edhe muajt kur kriza, e cila kërcënonte ndarjen e vendit, ishte më serioze.

### 3.1.2. Marrëveshja Kornizë (e Ohrit)

Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila qe arritur nën tryzni, dhe qe nënshkruar më 13 gusht të vitit 2001, nga ana e liderëve të katër partive më të mëdha politike në Maqedoni, nën patronazhin e kryetarit dhe të deleguarve të bashkësisë ndërkombëtare, kryesisht i ndërpreu armiqësitë që shpërthyen në fillimin e pranverës të vitit 2001. Nga njëra anë, Marrëveshja e përjashton përdorimin e dhunës për arritjen e synimeve politike dhe e pohon sovranitetin dhe integritetin territorial të Maqedonisë, si dhe karakterin unitar të shtetit. Nga ana tjetër, Marrëveshja nënvizon se karakteri multi-etnik i shoqërisë maqedonase, patjetër duhet të ruhet dhe të shprehet në jetën publike, përmes qasjes së re të zhvillimit të decentralizimit të pushtetit, jodiskriminimit dhe



përfaqësimit të drejtë, procedurave speciale parlamentare, si dhe përmes sistemit arsimor.

Sa i përket dinamikës, edhe pse të detyruar ta sigurojnë miratimin e 16 amandamenteve kushtetuese, duke përfshirë edhe preambulën, në një afat prej 45 ditësh nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë, kjo u realizua pas tre muajsh. Disa ligje të tjerë (nga lista e mësipërme) kaluan në Kuvend para zgjedhjeve më 2002. Megjithatë implementimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit ende pret klasifikimin e domosdoshëm, për shkak të botëkuptimeve të ndryshme të vetë dokumentit nga ana e nënshkruesve partiakë.

Nga ana tjetër, raportet dhe analizat më të reja (shih Shtesën 10), paralajmërojnë se popullata në Maqedoni duhet të bindet se respektimi i Marrëveshjes së Ohrit ka rrjedhojat e saja pozitive për të gjitha etnikumet në Maqedoni. Mendohet se disa përcaktime të Marrëveshjes, shpiejnë kah ndarja, në vend se kah integrimi. Prandaj, është vendimtare që të gjithë subjektet politike vendorë dhe ndërkombëtarë, ta orientojnë vëmendjen e tyre kah rrënjët e konfliktit dhe të kërkojnë mënyra se si do t'i zgjidhin në planin afatgjatë.

### 3.1.3. Gjendja momentale

Kriza e sigurisë prej vitit 2001, shkaktoi pasoja serioze politike dhe ekonomike, duke i ndërprerë reformat politike dhe zhvillimin ekonomik më 1999 dhe 2000, në të njëjtën kohë duke e rrezikuar stabilitetin mikroekonomik të vendit. Kjo solli ndjenjën e theksuar të pasigurisë dhe të pashpresës në mesin e të gjithë qytetarëve. Në vitet pas krizës, Republika e Maqedonisë, patjetër që do përballej me trashëgimi të vështirë.

Situata e sigurisë në vend ende nuk është stabilizuar tërësisht. Kriminaliteti i organizuar dhe korrupcioni, rriten vazhdimisht, kurse operacioni i ri për çarmatim, posa filloi. Megjithatë, kryesorja është zbatimi konsekuent i ligjeve në mbarë territorin e vendit.

Në këtë moment, papunësia dhe varfëria llogariten si problemet më të pranishëm të qytetarëve të Maqedonisë. Gjithashtu edhe mënyra se si duhet të zgjidhen në të ardhmen problemet e zhvillimi ekonomik dhe përcaktimet për sigurimin social. Në ndërkohë, mijëra punëtorë ende presin ndihmë, qytetarët e varfëruar, kërcënohen me greva të përgjithshme, kurse një serë çështjesh lidhur me personat e shpërngulur, ende presin zgjidhje.

### 3.2. Efektet sociale: shpërngulje dhe kthim

Sipas një vlerësimi, ndërmjet shpërthimit të konfliktit të armatosur në shkurt të vitit 2001, dhe përfundimit të marrëveshjes për paqe, nga rajonet e krizës, prej rreth 90 fshatra janë shpërnguluar 170.000 veta. Shpërngulja e arriti kulmin e vet në gusht të vitit 2001, me ç'rast rreth 70.000 veta qenë regjistruar si të shpërngulur brenda vendit<sup>(1)</sup>. Gjashtëdhjetë përqind prej tyre qenë maqedonas etnikë nga fshatrat përreth Kumanovës dhe Tetovës, si dhe prej vetë qytetit të Tetovës. Veç kësaj, mbi 58.000 refugjatë (shumica shqiptarë), gjetën strehë në Kosovë, Serbinë e Jugut dhe në Turqi. Sipas burimeve

zyrtare, të paktën 150 veta, kryesisht pjesëtarë të forcave ushtarake, u vranë në luftë. Nuk ka numra të saktë për ushtarët dhe civilët e vrarë shqiptarë. Mendohet se numri i viktimave civilë është i vogël.

Numri më i madh i të shpërngulurve brenda vendit u strehuan nëpër familje (më shpesh tek farefisi). Në kohën kur kriza me të shpërngulurit ishte më e theksuar, në gusht të vitit 2001, 60.662 të shpërngulur brenda vendit jetonin nëpër familje, ndërsa 3.857 veta qenë strehuar në 21 qendra kolektive (2).

Akteri kryesor humanitar gjatë krizës ishte Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK), së bashku me Kryqin e Kuq të Maqedonisë (KKM), të cilët ishin përgjegjës për evakuimin dhe regjistrimin e personave të shpërngulur brenda vendit në Maqedoni. UNHCR i regjistronte refugjatët të cilët hynin përmes kufirit me Kosovën dhe Serbinë dhe ngrinin kampe për t'i pranuar. Llogaritej se rreth dy të tretat e të shpërngulurve qenë shqiptarë etnikë, ndërsa të tjerët ishin maqedonas, romë, serbë.

Proçesi i kthimit filloi qysh në gusht, para se konflikti të ishte ndërprerë formalisht, derisa në disa vise ende kishte shpërngulje masovike. Bile gjatë betejave, dhe fill pas tyre, njerëzit shkonin dhe vinin nëpër shtëpitë e tyre. Ndër të parët që ktheheshin në mënyrë intenzive, ishin shqiptarët etnikë, të cilët kishin ikur në Kosovë. Proçesi i kthimit u intensifikua në vjeshtën e vitit 2001, kurse në fund të vitit 2001, numri i të shpërngulurve u zvogëlua në 30.000. Në gusht të vitit 2002, numri i përgjithshëm i të shpërngulurve brenda vendit, të strehuar nëpër familje, arrinte në 5.447 veta, ndërsa 1.974 veta ishin strehuar në qendrat kolektive. Në shtator të vitit 2003, numri i përgjithshëm i personave, të cilët qenë kthyer, është rreth 4.500 (shih Nënkapitullin 4.1)

Edhe pse dëmtimi material dhe shpërngulja qenë të kufizuar vetëm në disa rajone ku zhvilloheshin betejat më të ashpra, efektet e konfliktit u shtrinë shumë më gjerë. Fshatrat e anës tjetër “të vijës së frontit” (3) e pësonin në disa mënyrë: lëvizja e kufizuar rezultonte me humbjen e vendeve të punës, rënia e aktiviteteve afariste, kurse prania nëpër tregje ishte e kufizuar. Sektori bujqësor pati pasoja të mëdha: fshatarët

---

(1) Sipas Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit (The 2001 IHF Annual Report on Human Rights Violations), publikuar më 28 maj 2002.

(2) Sipas bazës globale të shënimeve për personat e shpërngulur brenda vendit të Këshillit Norvegjez për Refugjatët (Profile of Internal Displacement: Macedonia), publikuar në gusht të vitit 2002. Numrat e parë i ka regjistruar QMBN/KKM.

(3) Për shembull, fshatrat e komunës së Kumanovës, e cila kufizohet me komunën e Likovës, fshatra përreth Haraçinës dhe rajonit më të gjerë të Tetovës.

---

nuk kanë pasur mundësi të mbjellin dhe të korrin gjatë vitit 2001, kafshët ngordhnin për mungesë ushqimi. Pasojat afatgjata, megjithatë, kanë peshë të madhe. Jostabiliteti i vazhdueshëm e ka shkallmuar besimin dhe pati ndikim në ekonominë lokale në tërësi.

### 3.3. Kriza dhe pasojat ekonomike dhe socio-ekonomike të saj

Më vitin 2000, nëntë vjet pas pavarësisë dhe aplikimit të procesit të transformimit politik dhe ekonomik, nga ekonomi shtetërore (socialiste) në atë të tregut, Maqedonia ishte në rrugën e këndelljes ekonomike. Pasi u dëmtua në kaosin politik të rajonit, siç ishte embargoja tregtare ndaj Serbisë dhe lufta në Kosovë, kërkesa e tregut vendor rritej, edhe karshi investimeve edhe karshi konsumit.

I përkrahur nga rindërtimi i Kosovës fqinje, rritja reale e bruto prodhimit të vendit në vitin 2000, arriti 5,1%, shkalla më e lartë qysh nga fillimi i tranzicionit ekonomik (4). Më 2001, bruto prodhimi i vendit ra në 4,5%, më 2002 rritja mezi arriti në 0,3%.

Disa ekspertë pohojnë se zhvillimi ekonomik, si rezultat i sigurisë dhe krizës, u kthye prapa për një dekadë të plotë. Kjo si duket, megjithatë, është vetëm njëra anë e punëve. Edhe me rritjen e bruto prodhimit të vendit në vitin 2000, papunësia arriti shkallën prej 32,2%, që shënonte rënie vetëm për 0,9%. Papunësia zyrtare u dyfishua nga fillimi i procesit të tranzicionit, kurse shkalla më e lartë që shënuar më 1997 (36%), ndërsa vlerësimet sot sillen rreth 35-37%. Sipas disa hulumtimeve të hershme (5), shkalla e të punësuarve me orar të plotë pune në sektorin formal në vitin 2003 është 23%, që shënon rënie për 26% nga shtatori 2001! Fakt edhe më tronditës është ai i papunësisë të rinjtë. Një studim (6) shënon se në vitin 2002, thuajse gjysma e popullatës më të rinj se 30 vjet, asnjëherë nuk ka qenë formalisht e punësuar.

Në raportin për zhvillimin njerëzor (Programi për zhvillim i KB) për Maqedoninë (2001) thuhet:

-----

(4) Burim: UE Country Strategy Paper 2000-2006

(5) Raport për paralajmërimin me kohë të Programit për zhvillim të KB.

(6) ESI Fshati i Ahmetit

Gjatë nëntë vjetëve të tranzicionit, u bë transferimi kah fitimi i mjeteve për jetesë dhe i krijimit të të ardhurave joformale, duke përfshirë bujqësinë, tregtinë e vogël dhe aktivitetet ekonomike jolegale.

Kriminaliteti i organizuar, i trimëruar nga embargoja tregtare ndaj Serbisë në vitet e vona 90, konflikti në Kosovë, si dhe kriza e sigurisë më 2001, që shkaktuan vakuum sigurie në rajonet kufitare të pjesës veriperëndimore të vendit, lulëzonte duke rrezikuar stabilitetin. Nuk ka të dhëna të përdorshme për punësimin, për të ardhurat në rajonet e goditura, që do të mund të krahasoheshin me viset më pak të zhvilluara të Maqedonisë. Ndikimi më i madh mund të jetë ai psikologjik: në bashkësinë e biznesit, si dhe në mesin e qytetarëve të rëndomtë, është e pranishme ndjenja se, e ardhmja politike është e mirë, kurse rajoni nuk është i sigurtë. Investuesit mëdyshe, bankat komerciale nuk japin hua, pasi mendojnë se nuk janë të sigurt. Në këtë klimë të "mungesës së besimit", zhvillimi ekonomik gjendet në një krizë serioze.

---

Si rezyme e këtyre fakteve, vijmë në përfundim se rrënjët e krizës së tanishme ekonomike janë të një natyre shumë komplekse dhe patjetër që duhet parë në kontekstin e rënies ekonomike në Jugosllavi, 20 vjetët e fundit, gjatë procesit të tranzicionit ekonomik dhe trazirave politike në Ballkan, të cilat ndikuan gati te secili banor i Maqedonisë, si dhe në krizën e sigurisë, e cila i ktheu prapa të arriturat gjatë viteve të procesit të tranzicionit.

*Për informata të tjera:*

*Shtesa 10 Kontekst*

*Shtesa 3-4: Shpërngulja dhe rindërtimi*

*Shtesa 5-6: pasojat ekonomike dhe socio-ekonomike*

#### 4. KTHIMI DHE RIINTEGRIMI I TË SHPËRNGULURVE BRENDA VENDIT DHE I REFUGJATËVE

##### 4.1. Gjendja momentale me të kthyerit

Sipas shifrave të fundit të QMBN, deri në fillim të vitit 2003, nëpër qendrat kolektive dhe te familjet, kishin mbetur gati 10.000 të shpërngulur brenda vendit, si dhe 3.500 refugjatë në Kosovë. Këto numra zbritën në rreth 4.500 në shtator, që përbën një rënie prej 3%. Fjala është për 1.400 refugjatë në Kosovë dhe 3.154 të shpërngulur brenda vendit, nga 1.089 të vendosur në qendrat kolektive. Llogaritet se gati gjysma e të shpërngulurve brenda vendit, do të kthehen gjatë muajve të ardhshëm, pas meremetimit të shtëpive. Sa u përket të tjerëve, ata kanë arsye të ndryshme që të mos kthehen. Siç duket shumica syresh nuk ka gatishmëri për t'u kthyer në këto kushte, ose nuk duan të kthehen në vendbanimin e mëparshëm.

Ministri në ingjercat e të cilit është riintegrimi dhe rivitalizimi, mendon se procesi i kthimit gati ka përfunduar, ndërsa Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, e cila administron me qendrat kolektive, sikur nuk ndërmerr nisma për të gjetur zgjidhje. Një pjesë e agjensive ndërkombëtare po e kompletton fazën tjetër, kështu që disa syresh po përgatiten të tërhiqen, ndërsa të tjerat merren me aktivitete zhvillimore.

Disa prej të shpërngulurve brenda vendit, pasi janë kthyer në fshatrat e tyre, përballen me kanosje, kurse ka nja 70 shtëpi të cilat qenë grabitur pas meremetimit. Të shpërngulurit e qendrave kolektive, paraqitën disa kushte për t'u kthyer, të cilat Qeveria nuk është e gatshme t'i përfillë. Ata janë shumë të frustruar dhe llobojnë për synimet e tyre. Ata tërheqin vëmendje të madhe të opinionit dhe, si duket, janë të gatshëm edhe për ndonjë hap më radikal, siç është "demonstrimi para Kuvendit". Ata edhe më tutje paraqesin çështje politike, që në këtë moment delikat, është problematike, prandaj gjykohet se për këtë çështje duhet kujdes dhe zgjidhje e menjëherdhme.

Rreth 1.400 shqiptarë etnikë të ikur në Kosovë, nuk pajtohen me Qeverinë. UNHCR ende po u siguron ndihmë elementare me ushqime dhe me ndihma të tjera humanitare, si dhe përkrahje juridike dhe ndihmë individuale – si, psh., në rastet kur atyre që dëshirojnë të kthehen në Maqedoni, u kanë humbur dokumentat.

---

## 4.2. Masa për rehabilitimin dhe rikonstrukcionin

Politika e rikonstrukcionit bazohet në meremetimin e shtëpive private, sipas standardeve humanitare, dhe rehabilitimin të një pjese të infrastrukturës. Nuk është marrë parasysh dëmtimi i mobiljeve dhe i gjësendeve të shtëpisë, as i pajisjeve bujqësore dhe e biznesit, ose çfarë doqoftë veglash, etj.

### 4.2.1. Strehimi

Rreth 6.500 shtëpi private qenë paraqitur si të dëmtuara, kurse pjesa kryesore u rikonstruktuan, ose u meremetuan nga disa organizata ndërkombëtare. Politika e IMG është që të shfrytëzojë kompani ndërtimi vendëse – kryesisht nga rajoni i krizës – për të meremetuar shtëpitë. Ato ishin të detyruara të inkuadrojnë punëtorë nga fshatrat. Punohet në rreth 80 objekte, të cilat IMG pritet t'i përfundojë deri në fund të këtij viti. Deri në shtator të vitit 2003, edhe 170 shtëpi, ende s'ikishin filluar së ndërtuari – për arsye të ndryshme, siç janë mospasja e të dhënave të sakta se kush është pronari ose për moszgjidhjen e të drejtës së shfrytëzimit. Në 51 raste, pronarët refuzojnë t'i nënshkruajnë marrëveshjet tripalëshe me Qeverinë dhe IMG. Në listën e tyre për rikonstrukcion gjenden 70 shtëpi, të cilat qenë grabitur ose djegur para dokohe.

Qeveria është e kënaqur me punën e agjencive ndërkombëtare për rikonstrukcion. IMG mendon se detyra e tyre për rikonstrukcionin e shtëpive është gati e përfunduar. Por, disa fshatarë ankohen për trajtim joadekuat. Të tjerë mendojnë se janë harruar, derisa të dikush mendon se nuk u janë plotësuar premtimet. Ka edhe të tillë që ndjehen të mashtruar nga firmat lokale kontraktuese, ose për shkak të kualitetit të dobët, ose për shkak të pagesës së pamjaftueshme.

Ekipi pohoi se IMG i ka marrë parasysh ankesat e 130 fshatarëve të Sllupçanit. Një ekip i pavarur – si IMG i ftoi – i rishikoi ankesat, dhe erdhi në përfundim se, shtatë ankesa janë të arsyeshme. Megjithatë, komiteti lokal për rikonstrukcion gjykon se nuk i ka marrë përgjigjet e nevojshme. Si duket punët nuk kanë qenë gjithmonë transparente për fshatarët. Edhe pse në disa raste është mjaft vështirë kjo të realizohet, megjithatë, bashkëpunimi dhe koordinimi i Qeverisë dhe agjencinë për rindërtim me komitetet vendore duhej të ishte më e afërt. Ky shembull e ilustron nevojën për një trup të pavarur për hulumtimin e ankesave të këtilla.

Megjithatë, si duket, një problem është shkalla shumë e madhe e pritjes, shpesh joreale, e disa të shpërngulurve brenda vendit, që zhdëmtimi i pasojave të konfliktit të jetë i plotë. Agjencia ndërkombëtare pohon se niveli i rindërtimit të mundshëm në Maqedoni, është më i lartë se në disa vende të tjera. Edhe këtu ka nevojë për transparencë. Edhe për kundër kësaj, ekipi mendon se punët e rindërtimit, të cilat i ka realizuar IMG dhe agjencitë e tjera, janë të suksesshme. Por, politika e përfshirjes së kontraktuesve vendorë, në vend se pronarëve t'u jepet material për ndërtim, si në Kosovë – ndikoi për problemet e lartpërmendur.

---

#### 4.2.2. Infrastruktura

Rikonstrukcioni i infrastrukturës publike është fokusuar kryesisht te shkollat dhe ambulancat. Rreth 44 shkolla janë rehabilituar – kurse disa syresh nuk ishin dëmtuar fare. Shumë më pak kujdes i është kushtuar objekteve të tjera, si sistemit të ujësjellësit, ndërtesave komunale, qendrave të kulturës, tepujve të fesë etj. Megjithatë, disa OJQ kanë punuar në riparimin e ujësjellësve. Është mendim i përgjithshëm se në këtë plan duhet bërë më tepër.

Gërmadhat e ndërtesave komunale, veçanërisht objektet fetare, vazhdimish na e pëkuqtojnë konfliktin dhe ndikojnë në mënyrë negative në pajtimin e grupeve etnike!

Gjatë kohës së vizitave nëpër fshatra – pa marrë parasysh nëse është fjala për fshatra të goditur në mënyrë direkte, apo indirekte nga konflikti – njerëzit ankohen për infrastrukturën e dobët, sidomos kur është fjala për ujësjellës dhe sisteme sanitare, deponitë e bërlllogut, sallat komunale dhe sportive. Siç mund të shihet, edhe ekipi gjatë kohës së vizitës në pesë fshatrat, konstatoi se shumica e objekteve ishin në gjendje të keqe dhe kanë nevojë për resurse dhe kujdes. Megjithatë, në shumë vende, ekipi hasi në një kulturë ankmi, ndërsa fshatarëve u mungonte vetiniciativa kur është fjala për punë komerciale. Vendet për deponimin e bërlllogut dhe sallat sportive, mund të përmirësohen me lehtësi, me koordinimin e vetë fshatarëve, pa fonde të jashtme.

Megjithatë, rehabilitimi i infrastrukturës në viset e përfshira me konflikt – qoftë të goditura në mënyrë direkte ose indirekte – duhet të jetë prioritet.

Përgjegjësinë për këtë duhet ta marrë vetë Qeveria, dhe jo agjencitë ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, prezenca e dukshme e Qeverisë në këto vise, nuk do të reduktohej vetëm në prezencën e forcave policore, siç ishte rasti viteve të kaluara. Kjo do të ishte shenjë e mirë për ndërtimin e besimit në këto bashkësi. Për realizimin e këtyre programeve, ekziston nevoja e ngutshme për kapacitet në nivel lokal. Komitetet komunale dhe të fshatrave duhet të jenë në gjendje të planifikojnë dhe të koordinojnë masa për riintegrimin dhe zhvillimin e bashkësisë. Ekziston nevojë e dukshme për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet: kryetar komune, këshilla komunale dhe vendore, si dhe kompani publike.

#### 4.2.2. Hapësira komerciale

Deri tani nuk i është kushtuar kujdes i mjaftueshëm rikonstrukcionit të aktiviteteve komerciale, bile as bujqësisë ose ndonjë lloji tjetër të biznesit. Megjithatë, janë hapur disa biznese të vogla, pa mbështetje, kryesisht të niveleve të ulëta (psh. ferma për pula në Sllupçan). Disa kanë vështirësi t'i vazhdojnë punët e filluara në bujqësi për mungesë pajisjeje (shih gjithashtu nënkaptullin 5.5.2.). Minsitri i ngarkuar me rikonstrukcionin ka plane që këto dëme të kompenzohen. Edhe IMG po përgatit regjistrimin e sipërfaqeve të shkatërruara, ku ka pasur shitore ose ndonjë lloj tjetër veprimtarie shërbyese, por duke mënjanuar bizneset familjare dhe fermat familjare. Pritet që kjo të përfundojë deri fund të vitit 2003, dhe shërben për të aktivizuar fonde nga bashkësia donuese. (7)

---

Megjithatë, shtrohet pyetja, nëse ka kuptim që të bëhet rikonstruksioni i këtyre sipërfaqeve pas dy vjetësh. Vlerësimi duhet ta ketë parasysh gjendjen momentale të tyre. Pengesë tjetër është se, shumica e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe fermat më të vogla, nuk janë të regjistruara dhe për punën e tyre nuk është siguruar leja. Prandaj, do të jetë vështirë të krahasohet gjendja e tanishme me të përparshmen para konfliktit. Njëra nga alternativat është koncentrimi i masave për të promovuar rivitalizimin e biznesit – pa marrë parasysh nëse është dëmtuar ose jo – siç shkruan në Nënkapitullin 5.

(7) UNHCR bëri vlerësimin e dëmeve në vitin 2001, e që i përfshinte edhe objektet ekonomike.

#### 4.2.4. Masat për ndrëtimin e besimit

Përveç dëmeve materiale të shkaktuara nga konflikti, kishte edhe keqësime serioze të marrëdhënieve ndëretnike në Maqedoni, të manifestuara si probleme të sigurisë dhe humbje besimi. Konflikti ndikoi të rritet ndjenja e pasigurisë në mes të qytetarëve, në planin e kanosjes fizike, lirisë së kufizuar të lëvizjes, dhe mungesës së të drejtave të tjera elementare njerëzore. Besimi i humbur, kryesisht manifestohet në dy nivele: mosbesim tek institucionet qeveritare dhe mosbesim ndërmjet grupeve të ndryshme etnike.

Ka shumë shembuj që flasin për këto lloje të kanosjes pas konfliktit: 173 persona qenë vrarë pas konfliktit (8), mbi 10 veta qenë rrëmbyer dhe më pas qenë liruar; 18 veta ende konsiderohen të zhdukur gjatë kohës së konfliktit, ngjanë edhe shumë incidente (kryesisht eksplozime bombash në qendrat urbane).

U desht një kohë e gjatë që forcat policore multietnike të hyjnë nëpër fshatrat të përfshirë me krizën e mëparshme dhe të vënë kontroll. Vlerësimet për armët ilegale në Maqedoni sillen nga 40.000 deri më 400.000 copë. Prania e këtij armatimi që e posedojnë individët dhe disa grupe të armatosura (pas konfliktit grupi i quajtur Armata Kombëtare Shqiptare AKSH, shpalli vazhdimin e aktiviteteve luftarake), paraqet kanosje për stabilitetin dhe sigurinë.

Efekte të tjera janë ato psiko-sociale. Derisa traumat, për shkak të zhvendosjeve, mbase për disa të shpërngulur brenda vendit tani, tanimë i takojnë së kaluarës, duke marrë parasysh faktin se 95% u kthyen nëpër shtëpitë e tyre, megjithatë, 4.500 veta nuk e patën këtë fat. Disa nga personat më të goditur, gjithësesi janë ish luftëtarët, sidomos ata që u liruan nga shërbimi (të të dy palëve), dhe që për momentin nuk kanë angazhim. Marrëdhëniet ndëretnike para konfliktit, karakterizohen si stabile, dhe qenë potencuar si shembull në mbarë Ballkanin. Konflikti, si duket, më tepër pati pasojë të këto marrëdhënie, se sa të dëmet materiale.

Anketat e opinionit publik vazhdimisht tregojnë më tepër besim te jeta e përbashkët e bashkësive të ndryshme etnike, se sa ishte rasti para konfliktit.

Ende ka shumë indicje që flasin se kthimi i besimit do të jetë një proces i gjatë dhe i vështirë.

Deri tani ka pasur shumë aktivitete, të cilat quhen aktivitete për ndërtimin e besimit. OSBE trajnon personel të ri policor për patrullat e përziera (etnike) në rajonet e krizës. Disa kurse tani më kanë përfunduar, kurse patrullat janë caktuar që nga fundi i vitit 2001. OSBE ende patrullon nëpër rajonet e krizës, duke siguruar ndihmë për ekipet policore kur paraqitet nevoja, e cila ishte e një rëndësie të veçantë në fazën e parë të konfliktit, për të rivënë komunikimin ndërmjet forcave policore dhe fshatarëve.

(8) 102 veta u vranë brenda vitit 2002, kurse 71 veta u vranë më 2003, deri në fund të shtatorit.

Qeveria merret me çështjet e çarmatimit, amnestisë dhe riintegrit të ish pjesëtarëve të njësive të armatosura, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, me adoptimin e ligjeve të reja. Por, ky proces, në të ardhmen duhet të implementohet, kurse deri tani po tregon një nivel të ulët të pjesëmarrjes së subjekteve të shoqërisë civile.

Kur është fjala për marrëdhëniet ndëretnike, më shumë se 12 OJQ lokale bënë fushatën “Mjaft më!”, gjatë kohës së konfliktit dhe një vit pas tij, me qëllim ta ngrejë vetëdijen e opinionit për pasojat e vazhdimit të konfliktit. Agjencia Evropiane për Rikonstruktivitet (EAP) bëri ftesë publike për propozime për projektet, të cilët parashohin angazhime për përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike në vend. Në fillim të vitit 2003, qenë lejuar pesë projekte, me vlerë prej një milion eurosh. Aktiviteti më i madh në këtë plan ishte Iniciativa për Ndërtimin e Besimit. E financuar nga USAID/OTI, dhe e implementuar në bashkëpunim me OJQ, ajo kapte shumë prej 11 milion USD. Mirëpo, pjesa më e madhe e projekteve, ishin për përmirësimin e infrastrukturës, dhe janë shënuar te Nënkapitulli: Rindërtimi. Disa nga aktivitetet “e buta” janë: botimi i revistave multietnike, prodhimi i programeve TV, financimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive, këmbimi i vizitave, trajnimi për ndërmjetësim, punëtori për të drejtat e njeriut dhe zgjidhja e konflikteve. USAID zbatoi evaluadimin e programit për Iniciativën për Ndërtimin e Besimit. (9)

#### 4.3. Riintegrimi

##### 4.3.1. Faktorët socio-etnikë

Sipas shumë njerëzve, faktori socio-ekonomik ishte njëri nga faktorët më të rëndësishëm të krizës. Marrëveshja Kornizë siguroi kornizë për stabilizimin e marrëdhënieve ndëretnike, kurse Qeveria është optimiste në këtë plan. “Kjo nuk është Kosovë, ne mosmarrëveshjet mund t’i zgjidhim me dialog”, thotë zëvendëskryeministri Musa Xhaferi. Megjithatë, implementimi i Marrëveshjes has në shumë sfida.

(9) Pritet që raporti të finalizohet në tetor 2003.

---



Studimi bënte identifikimin e një numri të madh shembujsh pozitivë dhe negativë, me të cilat dëshmohet se sa janë të ndjeshme marrëdhëniet ndëretnike pas krizës. Kishte raste kur liderët vendorë ishin marrë vesh që të mos inkuadrohen në konflikt (Kopanicë, Jegunovcë - rajoni i Teovës), që është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me rastin kur nuk mund të arrihej marrëveshje për emrin e një shkolle, që shpuri te përçarja e bashkësisë (Shemshevë, Jegunovcë, Tetovë).

Kthimi i sigurisë dhe i besimit (përmes, psh. rritjes së sigurisë përmes pranisë më të madhe të policisë, me qëndrim që, më tepër të ndihmohet, se sa të kontrollohet), është kyç për kthimin dhe riintegrimin e të shpërngulurve brenda vendit. Deri tani kanë rënë në ujë disa përpjekje nga ana e interesave afatshkurta të akterëve politikë, dhe të palëve të tjera të interesuara. Në këtë drejtim, ende ka shembuj të dallimeve të mëdha në perceptimin e secilës bashkësi etnike. Maqedonasit ndjehen të rrezikuar, ndërsa shqiptarët ndjehen të diskriminuar nga ana e shumicës. Stereotipet ndëretnike ende janë të fuqishme – akuzohet pala tjetër se, nuk dëshiron të bashkëpunojë, të komunikojë etj. Në këtë drejtim nuk është lehtë të zgjidhen problemet me tendencë homogjenizimi etnik.

Megjithatë, kishte shembuj të marrëdhënieve stabile multietnike, të bazuara në besimin e ndërsjellë, që nuk tërhoqi vëmendjen e mjaftueshme të Qeverisë dhe të agjencive humanitare ndërkombëtare (Saraj, Kopanicë, Jagunovcë). Këto bashkësi kanë përshtypjen se, askush nuk kujdeset për to, ndjehen të përjashtuara nga ndihma e donatorëve, dhe mendojnë se përpjekjet e tyre nuk pranohen. Është e qartë se, dhe këtë e dëshmuar edhe shumë të intervistuar, se kualiteti i jetesës është më i keq, se sa para krizës. Ky fakt bën presion mbi situatën e përgjithshme, duke përfshirë këtu edhe stabilitetin social dhe të marrëdhënieve ndëretnike. Midis tjerash, edhe varfëria, papunësia dhe korrupcioni, përmenden shpesh si probleme kyç. Ekziston nevoja vitale për përmirësimin dhe kthimin e besimit dhe mirëkuptimit ndërmjet dy grupeve etnike. Mu për këtë, nevojiten aktivitete në të gjitha nivelet: në nivel Qeverie, pushtetit vendor dhe shoqërisë civile. Marrëdhëniet ndëretnike mund të merren si çështje kruciale.

#### 4.3.2. Faktorët e sigurisë

Gjendja e përgjithshme e sigurisë pas konfliktit, po përmirësohet në mënyrë graduale, por ende ka një numër të madh incidentesh. Një numër i incidenteve me armë, ku kishte edhe të vrarë, shpjegohet si përleshje midis bandave kriminale. Kishte edhe disa sulme mbi institucionet qeveritare (ndërtesa e Qeverisë, kazerma ushtarake, Gjyqi në Shkup), si dhe mbi objekte të tjerë publike (gjimnazi në Kumanovë), por në asnjë rast nuk kishte viktima.

Kthimi i policisë në rajonet e krizës, kishte përfunduar me vonesë. Disa stacione policore duhej të rinovohen. Patrullat policore multietnike, të trajnuara me ndihmën e OSBE-së, tani patrollojnë rregullisht nëpër të gjitha fshatrat. Prania e policisë përmes patrullave dhe punkteve është mjaft e dukshme në ish rajonet e krizës. Ndihma ndërkombëtare ushtarake (forcat e NATO-s, të

cilat qenë zëvendësuar me EUFOR), ishte e rëndësishme gjatë konfliktit. Njësitë ushtarake vazhdimisht zvogëlohen, dhe roli i tyre tanimë bëhet më shumë konsultante, duke siguruar këshilla lidhur me çështjet e sigurisë, në vend të pranisë ushtarake në terren. Qeveria planifikon që misioni (Konkordia) të përfundojë – në pajtim me vlerësimet se gjendja e sigurisë është e ndjeshme, por stabile, dhe të mbështetet vetëm tek forcat maqedonase të sigurisë: ushtrisë dhe policisë. Agjencitë ndërkombëtare, gjithashtu pajtohen se, incidentet e mëparshme janë pasojë e veprimeve kriminale dhe nuk paraqesin kanosje për stabilitetin e vendit. Fshatarët përgjithësisht janë të kënaqur me aktivitetet e policisë, dhe pohojnë se ekziston një numër i madh sfidash me të cilat duhet të përballlet policia në këtë fazë të periudhës postkonfliktuale. Në dy fshatra, shqiptarët etnikë e theksojnë rëndësinë e komunikimit me policinë në gjuhën e tyre, dhe shohin përparim në tejkalimin e ndjenjës të qenurit i diskriminuar. Mirëpo, maqedonasit etnikë, sidomos të shpërngulurit brenda vendit, të cilët ende nuk janë kthyer, ndjejen të rrezikuar. Ata preferojnë prani më të madhe të policisë në terren, bile e nënvizojnë çështjen e çarmatimit si shumë të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së sigurisë dhe të lirisë së qarkullimit. Sigurimi i mundësive dhe kushteve për rivitalizim dhe zhvillim më efektiv, do të thotë mbrojtje juridike më efikase për qytetarët dhe për bizneset e tyre. Duke marrë parasysh se ende ekzistojnë disa vise në rajonet e krizës, ku ligjet nuk mund të zbatohen plotësisht, kjo gjykohet si prioritet. Kishte raste (komuna e Kumanovës dhe e Likovës), ku Qeveria nuk kishte mundësi t'i kontrollonte të gjitha viset për t'i gjetur kundërvajtësit në bazë të fakteve. Ekipi për vlerësim nuk u ndesh me problemet e sigurisë në viset rurale, por ishte dëshmitar i një këmbim zjarri në qendër të Kumanovës.

#### 4.3.3. Faktorët ekonomikë

Reintegrimi gjithashtu varet nga standari i jetesës. Njerëzve u duhet besimi se nevojat e tyre elementare do të kënaqen. Fill pas krizës, ky aspekt që mbuluar me paqeta humanitare, proces ky që funksiononte fare mirë. Sot shumica e të kthyerve, i kënaq nevojat e veta elementare të jetesës me aktivitet bujqësor – në shumicën e rasteve, për ta ushqyer familjen. Shumica kanë burime të ndryshme të të ardhurave, siç është ndihma sociale (rreth 40 euro mesatarisht), ndihmë prej familjes më të gjerë ose të holla që ua dërgojnë anëtarët që jetojnë jashtë vendit. Megjithatë, për shumicën e familjeve, është larg të kënaqshmes. (Për informata të tjera shih Nënkapitullin 5.5.2.)

#### 4.3.4. Gratë /gjinia

Gjatë misionit të vlerësimit, ekipi u përpoq që kujdes të posaçëm t'u kushtojë çështjeve që lidhen me gratë dhe me të rinjtë. Kjo ishte karakteristike gjatë vizitës në terren, ku me këta njerëz organizohej biseda grupore. Sidomos te bashkësitë etnike shqiptare, të cilat kryesisht jetojnë në mjedise rurale, gratë më së shpeshti janë angazhuar me punë familjare në bujqësi. Gjithashtu, aktivitetet rreth shtëpisë janë barrë e tyre.

Në të kaluarën një numër fare i vogël i shqiptareve ka pasur qasje punësimi, kryesisht për shkak të barrierave kulturore, por edhe si rezultat i praktikës së përgjithshme të punësimit (shih Nënkapitullin 5). Njëri ndër problemet kyç është

niveli i ulët i arsimimit në mesin e shqiptareve. Megjithatë, ekziston vetëdije për rëndësinë e arsimimit, që duket nga shtimi i numrit të vajzave, të cilat për momentin ndjekin shkolla të mesme dhe fakultete, si dhe përmes gatishmërisë së grave që ta lejojnë dhe ta nxisin këtë proces, edhe për kundër barrierave ekzistuese kulturore dhe të traditës.

Te maqedonasit dhe te serbët etnikë, gratë kanë pasur qasje më të mirë në punësimin publik dhe industrial. Disa gra, me të cilat kanë biseduar anëtarët e ekipit, kanë qenë të punësuar në industrinë e tekstilit dhe në industri të tjera, si dhe në administratën publike. Sa u përket meshkujve, ata ndeshen me gjendjen e përgjithshme të papunësisë dhe të pasigurisë të vendeve të punës.

Nga ana tjetër, te gratë ekziston mungesa e dukshme e shkathtësive sipërmarrëse dhe menaxhuese. Kështu që, nuk janë të pranishme në vende pune, gjë që do ta nënkuptonte përgjegjësinë më të madhe, dhe aq më pak, kanë mundësi të nisin biznes vetiak. Kur është fjala për mundësitë aktuale, gratë e shprehën nevojën për jetesë më intenzive dhe më të strukturuar në fshat, si themelimin e klubeve sociale, qendrat komunale, formimin e shoqatave qytetare. Disa prej grave në të kaluarën kanë bërë përpjekje që të kenë komunikim, bashkëpunim, dhe të këmbëjnë vizita me grupe grashë me origjinë të ndryshme etnike, në fshatin e tyre, por edhe në fshatrat fqinj. Aktivitetet e tilla duhet të vazhdojnë, të trimërohen dhe të intensifikohen, përkundër të gjitha pengesave.

#### 4.3.5. Aspekti i të rinjve

Edhe pse nuk është fokusuar si çështje më vete, lidhur me të rinjtë, ky studim i identifikon të rinjtë si grup social kritik për suksesin e procesit të reintegrimit.

Në këtë

moment, mendohet se ata nuk janë të përkrahur dhe të stimuluar për t'i shfrytëzuar mundësitë e tyre dhe t'i përmbushin obligimet e tyre për të pasur rol aktiv në ndërtimin e bashkësisë së tyre. Gjendja e përgjithshme politike dhe ekonomike në Maqedoni, sidomos kushtet e vështira të jetesës në rajonet e krizës, sa u përket të rinjve, rezultuan me pasoja të ndryshme sociale:

- Mungesa e pavarësisë
- Hyrja me vonesë në tregun e punës
- Migrimi i fuqisë punëtore ose shpresa për migrim

Sjellja e përgjithshme me rrisht, kontrabandimi me njerëz, drogë dhe armë, si dhe sjellja tjetër antisociale, është rritur kohëve të fundit.

Papunësia te të rinjtë theksohet si problem kryesor. Politika qeveritare për përkrahjen e punësimit, nuk është gjithmonë në pajtim me kërkesat e të rinjve, dhe deri tani nuk janë gjendur masa adekuate. Bile, aq më tepër, kur bëhet fjalë për strategji për zvogëlimin e papunësisë. Edhe pse nuk janë bërë hulumtime për shkaqet e papunësisë te të rinjtë, si duket, stagnimi i tregut të punës, bashkë me dituritë joadekuate (dituritë që disponohen nuk u përgjigjen kërkesave të punëdhënësit), janë arsye kryesore.

---

## 5. RIVITALIZIMI I RAJONEVE TË GODITURA NGA KONFLIKTI

### 5.1. Progres i arritur në rivitalizimin ekonomik

Gjatë vlerësimit të përparimit në fushën e rivitalizimit, ekipi hasi në vështirësi për të siguruar të dhëna të verifikuara për t'u provohuar deklaratat, të cilat i kanë dhënë përfaqësuesit e bashkësive lokale. Pastaj, problemet ekonomike në rajonet e krizës, në shumë mënyra, janë tipike edhe për viset më pak të zhvilluara në Maqedoni, të cilat nuk janë të goditura në mënyrë të drejtpërdrejtë nga konflikti.

#### 5.2.4. Progresi i përgjithshëm i arritur dhe roli i Qeverisë dhe i donatorëve

Qëndrim i përgjithshëm i komunave të goditura, i Qeverisë dhe i OJQ është se, jeta rurale dhe ekonomia lokale në rajonet e goditura nga konflikti, nuk e gëzuan vëmendjen e mjaftueshme. Jeta e fshatarëve është goditur nga disa faktorë: humbja e kafshëve gjatë konfliktit, grabitja ose dëmi i makinave bujqësore (10), humbja e tregjeve, humbja e vendeve të punës. Por, një përparim i vogël është arritur në rikonstrukcionin e objekteve ekonomike, sidomos në mjediset e përziera etnike. Një nga shembujt është industria e tekstit *Mateks* në Tearcë, e cila në vitin 2000, kishte 200 të punësuar, kurse tani ende është në gjendje katastrofike. Problemet me personat e shpërngulur brenda vendit, të cilët ende nuk janë kthyer plotësisht në shtëpitë e tyre – edhe përkundër faktit se shtëpitë e tyre qenë riparuar – mund t'i përshkruhet faktit se këta njerëz, jo vetëm që kanë humbur orënditë e shtëpisë, tërësisht ose pjesërisht, por kanë humbur edhe bazën ekonomike, ose ajo u është dobësuar ndjeshëm (shih 4.1).

Procesi i ngadalshëm i ripërtrijës ekonomike i përshkruhet kryesisht dobësive të ekonomive nacionale (shih Nënkapitullin 3, Efektet ekonomike të krizës). Bashkësitë, të cilat në masë të madhe varen nga të ardhurat e punësimit në industri (psh. pakiva maqedonase në rajonin e Tetovës), qenë goditur në mënyrë të veçantë nga kriza e papunësisë.

Për donatorët kryesorë në Maqedoni, zhvillimi ekonomik ka zënë dhe vazhdon të zërë vend të lartë në agjendat e tyre. Tre donatorët kryesorë, UE, SHBA dhe Holanda, promovojnë programe nacionale për përkrahjen e reformave ekonomike, disa donatorë bilateralë (psh. Gjermania, Britania e Madhe, Kanadaja) si dhe OJQ (QMBN, MEDF, ESA etj) maqedonase, janë kyçyr në programet për zhvillimin e biznesit (11).

Mirëpo, shumica e donatorëve duan t'i zgjidhin problemet ekonomike në nivel shtetëror, dhe as kanë implementuar as që kanë financuar projekte për rivitalizimin e rajoneve të krizës.

Qeveria nuk implementoi masa specifike për ta stimuluar këndelljen në rajonet e goditura nga konflikti (instrumentat e zakonshme që përdoren në vende të tjera për investime (psh. nxitje tatimore), ose subvencione direkte / kompezime për të humburën/. Dy vjet pas përfundimit të krizës, Qeveria ende nuk është përgjigjur, apo ta ketë sqaruar strategjinë për rivitalizimin e ekonomisë (12). Me mungesë të strategjive kohezive, intervenimet e

donatorëve (multilateralë, joqeveritarë) mbeten të izoluar dhe të pakoordinuar. Për përgjigjen e saj të vonuar, Qeverinë e kritikojnë orgnazata të ndryshme, si dhe bashkësi biznesi. Shtrohet pyetja, nëse Qeveria nacionale i ka dhënë prioritet të mjaftueshëm rivitalizimit ekonomik dhe, nëse e sheh financimin vetëm si përgjegjësi të agjencive donatore. Të tjerët e kritikojnë joefikasitetin dhe theksojnë se ka një koordinim të pamjaftueshëm ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë, përgjegjës për kthimin e të shpërngulurve brenda vendit dhe rindërtim me Byronë për Zhvillimin e Rajoneve të Pazhvilluara. Kjo Byro që e detyruar të përballet me shkurtimin e buxhetit prej 850 milionë denarësh për vitin 2002, në 250 milionë denarë për vitin 2003, edhe pse rivitalizimi ende nuk ka përfunduar. Pushtiti vendor nuk ka pasur dhe nuk ka buxhet vetanak për implementimin e masave për rihabilitim, apo asqë ka rol dhe kapacitet të bëhet nismëtar i rivitalizimit ekonomik.

-----

(11) Programet për zhvillim të MEDE janë financuar nga Holanda.

(12) Sipas Vlado Popovskit, ministër pa resor, kabineti qeveritar ka marrë vendim të zhvillojë një plan për rindërtimin ekonomik të rajoneve të krizës. Korniza planifikuese e këtij plani, duhet të jetë gati deri në fund të vitit 2003.

Ne nuk e dimë se deri në çfarë shkalle politika e përshtatshmërisë strukturore të FNM, të Bankës Botërore për Maqedoninë dhe anëtarësia në OTB, kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë mbi fleksibilitetin e Qeverisë gjatë hartimit të strategjisë për këndellje. Është jashtë kapacitetit të këtij vlerësimi që t'i hulumtojë çështjet nga lëmi i politikës makro-ekonomike. Megjithatë, leksionet e mësuara nga vendet e tjera, thonë se politika e përshtatshmërisë strukturore, të praktikuara në kushtet pas krizës, mund të jetë kontraproduktive për këndelljen ekonomike.

*“Programet për reforma, siç janë programet për përshtatshmërinë strukturore, reformat ekonomike dhe privatizimi mund të sjellin deri te një disparitet më të madh, alokacion të ndryshëm të resurseve dhe, me pasojat e tyre, mund të ndikojë për konflikte...” (13).*

Dhe mund të përfundojmë se, dy vitet e para pas krizës, rivitalizimi ekonomik nuk ka qenë as prioritet i Qeverisë, as i donatorëve. Kjo politikë është me pikëpyetje. Është përvojë e mirë që gjatë rehabilitimit postkonfliktual, t'i kushtohet kujdes më i madh rivitalizimit ekonomik qysh në fazat e para pas konfliktit. Kështu nuk ndodhi në Maqedoni.

#### 5.2.5. Përparim i arritur në vinel të bashkësive, roli i sektorit privat

Në mikro-nivel, ka mjaft shenja të këndelljes ekonomike. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në tregti dhe në shërbime (dyqane, kafene, rrojtore, garazhe) dhe ato që ndërlidhen me sektorin e ndërtimitarisë, kryesisht janë rehabilituar pa ndihmën e drejtpërdrejtë institucionale. Politika e IMG (dhe organizatave të tjera të përfshira në rindërtimin e shtëpive), që t'u jepet përparësi firmave të rajonit, gjithësesi u ka ndihmuar disa bizneseve lokale për t'u zhvilluar. Mirëpo, vlerësohet se “kapaciteti për vetëndihmë”, te shqiptarët etnikë ka qenë faktor vendimtar për rivitalizimin e ndërmarrjeve lokale. Lidhjet e ngushta familjare dhe dërgimi i të hollave nga kurbetçinjtë në Evropën Perëndimore,

kanë luajtur rol vendimtar. (14) Faktorë të tjerë kanë qenë bashkësitë sipërmarrëse në Kosovë dhe në pjesë të tjera të ish Jugosllavisë.

Grupet etnike, që janë pakica në bashkësitë e tyre, ndeshen me pengesa serioze në rindërtimin e jetës dhe punës së tyre normale. Në mesin e përkufizimeve gjenden edhe: siguria permanente dhe dëmtimi i mjeteve komerciale, mungesa e mbështetjes nga autoritetet lokale në çështjet e sigurisë dhe mungesa e kapitalit (qasje më e dobët e kapitalit te mërgimtarët, në krahasim me shqiptarët etnikë).

-----  
(13) Promovimi i jetës së përditshme normale dhe punësimi pas krizës, FAKT 2003

(14) Shih, gjithashtu, pjesën për faktorët socio-ekonomikë dhe varfëria

Ekipi ka hetuar ndyrshime të rëndësishme regjionale. Derisa sektori i biznesit në rajonin e Tetovës (sidomos në komunën e Tetovës), është në rrugë e sipër për t'u përmirësuar. Ekipi ka përshtypjen se komunat e rajonit të Kumanovës (komuna e Likovës) mbeten prapa. (15) Tendenca e tanishme e shpreh gjendjen e parakonfliktit.

Psh. në komunën e Tearcës, ka më shumë diversitet në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, se sa në komunën e Likovës, kryesisht bujqësore. Komunat rurale, si në ato të goditura në mënyrë direkte, si në ato të goditura në mënyrë indirekte, ndeshen me barrë të dyfishtë: të këndellen nga humbjet dhe dëmet e shkaktuara nga konflikti, dhe të përballen me stagnimin e tregjeve në sektorin bujqësor.

Sektori privat ka dinamikën dhe potencialin e tij të përballet me efektet e krizës. Por, pasiguria lidhur me politikën zhvillimore – bashkë me mosbesimin te institucionet publike – janë disa nga pengesat kyçe për investimet private në rajonet e goditura nga konflikti, si dhe në rajonet fqinj. Kjo është më e dukshme në politikën e institucioneve financiare. Për hipoteka, bankat komerciale pranojnë vetëm ato kolaterale prej qyteteve jashtë ish rajoneve të krizës, si dhe nga rajonet që kufizohen me to. Studimet e rasteve japin të dhëna për këtë politikë. Bile, tani së shpejti, një institucion mikrofinanciar i inauguruar në Tetovë, nisi të sigurojë hua të vogla (16) për ndërmarrjet e komunës së Tetovës dhe më gjerë.

Politika restriktive e bankave komerciale, dëshpëruan shumë njerëz nga rajonet e krizës, sidomos ata që duhet të përballen me humbjet, pa mundësi qasjeje te burime të tjera (anëtarë familjeje që jetojnë jashtë):

Kryetari i Këshillit vendor të fshatit Tearcë: "Ne jemi nën embargon kapitale".  
Një bujk nga fshati Novo Sellë: "Kur vajta në bakë të kërkoj hua, më pyetën nëse kam pasuri në Shkup. Nuk kam. Unë e kam vetëm shtëpinë time këtu. Më thanë se për ata kjo shtëpi nuk ka vlerë!"

### 5.3. Gjendja socio-ekonomike në rajonet e krizës

#### 5.3.4. Kriza ma papunësinë

Njerëzit nga rajonet të goditur nga konflikti, e kundrojnë papunësinë si pengesën kryesore për arritjen e stabilitetit të përhershëm. Këtë qëndrim e kanë të gjitha grupet etnike, Qeveria, si dhe institucionet e huaja me të cilët kontaktojmë. Konstatimet tona

-----

(15) Ky konstatim është i paverifikuar me fakte. Një hulumtim statistikor i papunësisë (shih Shtesën 6) jep indicje të kundërta (rritja e papunësisë më 2002, ishte më e madhe në Tetovë, se sa në Kumanovë).

(16) Banka Procredite në Tetovë filloi me operacione më 2003 dhe ka paguar 200 hua në gusht të vitit 2003 për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të rajonit të Tetovës dhe të Kumanovës, me një vlerë të përgjithshme prej 300.000 euro.

pajtohen me ato të studimeve të tjera. Sipas Raportit për paralajmërimin me kohë, të cilin e shpalli Programi për Zhvillim i OKB në mars të vitit 2003, del se 78% e maqedonasve e radhisin papunësinë në vend të parë si problem, i cili i shqetëson më së shumti.

Nga viti 1996 papunësia sillet prej 30-36%. Më 2001, niveli relativ i varfërisë në rajonet rurale ishte 27,5%, ndërsa në Shkup arrinte 13,4%. Mirëpo, disa studime flasin për tendencën e rritjes së papunësisë dhe të varfërisë në mjediset urbane. Personat e papunë në mjediset urbane, kanë më pak alternativa, se sa banorët e viseve rurale. Në Tetovë, sipas një burimi, papunësia nga viti 2000, deri më 2002, është rritur për 50%(!), ndërsa në pjesët rurale të Tetovës është rritur "vetëm" për 30% (shih Shtesën 6). Për krahasim: Në Shkup, papunësia në të njëjtën kohë është zvogëluar për 7,6%. Nuk është e mundur të krahasohet varfëria dhe niveli i papunësisë në rajonet e krizës, me vise të tjera më pak të zhvilluara jashtë rajoneve me konflikte. As të dhënat statistikore ndërmjet grupeve etnike nuk dallojnë. Rindërtimi i shtëpive, i financuar nga donatorët, mundësoi punësim të përkohshëm dhe të ardhura për bashkësinë lokale. Sipas IMB, 10-50% e fuqisë punëtore (kryesisht e pakualifikuar), ishte angazhuar në fshat, dhe shumica e kompanive vijnë nga rajonet e krizës.

Edhe një kontribut për punësimin e përkohshëm janë të ashtuquajturat "programe për ndikime të shpejta", siç janë:

- Iniciativa Maqedonase për Ndërtimin e Besimit, e sponsorizuar nga USAID, e cila përfshin instalimin dhe rehabilitimin e objekteve komunale (buxheti i përgjithëm është 11 milion USD) (17)
- Projekte për ndikim të shpejtë, të cilët i implementonte UNHCR, me një shumë prej 1,5 milion USD
- Projekte për përgjigje krizës, të koordinuara nga Programi për Zhvillim i OKB, duke përfshirë aty edhe Programin për mbështetje urgjente bashkësive (riparime të infrastrukturës dhe aktivitete për përmirësimin e mjedisit jetësor, si pastrimi i vendeve për deponimin e bërlllokut në 15 komuna, me buxhet të përgjithshëm prej 400.000 USD)

-----

(17) Për më tepër informata, shih Shtesën 4, rehabilitimi.

---

### 5.2.2. Strategjitë për përballje

Të hollat që mërgimtarët e vendeve të Evropës Perëndimore i kanë dërguar, në një masë të madhe u kanë ndihmuar njerëzve, sidomos në bashkësinë etnike shqiptare, që ata të përballen me vështirësitë ekonomike pas krizës. Studimet dëshmojnë se, përveç bujqësisë dhe tregtisë informale, këto të holla zënë vendin e dytë të burimeve të rëndësishme të të ardhurave për familjet rurale. Nuk ka të dhëna të besueshme për vëllimin e të hollave, të cilat janë dërguar nga jashtë. (18)

Shqiptarët etnikë, duke marrë parasysh faktin se janë përjashtuar nga vendet e punës shoqërore, dhe janë të padrejtësuar në planin e qasjes të punësimit industriale, qenë të detyruar të kërkojnë strategji ekonomike – pra, të pajisen me shpirt sipërmarrësi – me të cilin, më së miri mund të përballen me rënien e sistemit socialist dhe efektet socio-ekonomike të krizës.

Aktivitet bujqësorë ishin burimet kryesore të mjeteve për ekzistencë para krizës, por edhe sot. Në Sllupçan, sipas informatave, 95% të banorëve janë të angazhuar në bujqësi, tërësisht ose pjesërisht. Në Novo Sellë, bujqësia u bë aktivitet ekonomik për 80-90% të banorëve pas humbjes së vendeve të punës në sektorin industrial. Në mesin e të intervistuarve kishte edhe persona të sapo diplomuar, si dhe një numër të madh me moshë mesatare dhe të moshuar, të cilët nuk kishin alternativë ekonomike.

Burime të tjera të rëndësishme në mjediset rurale, ishin edhe ato nga punësimi i përkohshëm, tregtia dhe nga mikro-biznesi (19), dhe të mos e përmendim “ekonominë joformale”. Një numër i madh i shqiptarëve punojnë në sektorin e ndërtimitarisë, por nuk janë në marrëdhënie të rregullt pune. Ky sektor, siç qe përmendur edhe më lart, përjetoi zhvillim brenda dy viteve të fundit me paratë e donatorëve për rikonstruksionin dhe meremetimin e infrastrukturës.

Ky zhvillim gjithësesi do të jetë nën ndikimin e ndarjes së ndihmave nga donatorët, derisa alternativa të tjera ekonomike nuk duken, pasi ka pakë investime në sektorin prodhues.

### 5.2.3. Efekte të transformimit ekonomik për jetesën e njerëzve.

Element kyç i Marrëveshjes Kornizë (të Ohrit), është ndërprerja e praktikave restriktive të punësimit dhe në mënyrë graduale të rritet pjesëmarrja e grupeve pakica në vendet e punës në sektorin publik.

-----  
(18) Vlerësohet se rreth 100.000 shqiptarë etnikë nga Maqedonia punojnë dhe jetojnë jashtë vendit. Një bankë flet për katëqind milion euro në muaj që i pranon vetëm ky institucion, kurse burime të tjera pohojnë se tranferet e të hollave të vlerësuara nga jashtë, të cilat shfrytëzojnë kapital institucional, janë mbi 10 milion euro. Një studim për Kërçovën (qytetin e Ali Ahmetit: ESI 2002), vlerëson se shumica e të hollave të dërguara nga jashtë është 16 milion euro në vit, vetëm për këtë komunë.

(19) Kur gjenden në krizë ekonomike, njerëzit zakonisht mirren me aktivitete, të cilat kërkojnë pak investime. Një shembull është prerja e drurëve për ngrohje. Kjo ngjet zakonisht me pyjet në pronësi të shtetit. Kjo praktikë shpie kah zhdukja e pyjeve dhe kah pasojat afatgjata ekologjike.

---



Para pak kohe, qe shpallur një konkurs për 600 vende pune për grupet pakica në të cilin u paraqitën 6000 veta. Ky potez, edhe pse me rëndësi të madhe politike, nuk do të ndikojë në gjendjen e përgjithshme të papunësisë në rajonet e krizës.

Procesi i transformimit ekonomik – me fokusim në privatizimin e firmave në pronësi formale të shtetit – ka ndikim në jetën e secilit banor të Maqedonisë. Nëntëdhjetë e pesë përqind të procesit të privatizimit është realizuar, dhe si rezultat llogaritet fakti që kompanitë, posa kalojnë në duart e udhëheqjes së re, e zvogëlojnë fuqinë punëtore (shih studimin për rastin e Jegunovcës).

Për banorët e rajoneve të goditura nga konflikti, të cilët kanë alternativa të pakta ekonomike (sidomos pakicat etnike), gjendja është më e keqe se sa për maqedonasin mesatar. Dy grupet më të mëdha etnike në pjesën veriperëndimore të vendit, maqedonasi dhe shqiptarët, e përjetojnë transformimin ekonomik nga disa këndvështrime të mundshme:

- Për shumicën e maqedonasve etnikë, transformimi ekonomik është sinonim për rënien e kualitetit të standardit të jetesës së tyre. Gjatë kohës së socializmit, një numër i madh i maqedonasve – duke marrë parasysh se i ndjenin anët pozitive të ekonomisë dyzetëvjeçare socialiste – hoqën dorë nga bujqësia, si burim plotësues të ardhurash, punësimi në degën industriale u mundësoi alternativa të shumëta. Me mbylljen e shumë vendeve të punës në sektorin formal, se sa hapja e vendeve të reja, shumë amvisëri maqedonase u gjendën në kufirin e varfërisë. Në ish rajonet e krizës, gjendja e tillë, është ende më e keqe, ku bashkësia afariste maqedonase ende mëdyshet për të investuar në rehabilitimin e biznesit e zhdukur nga lufta.
- Shqiptarët etnikë, të cilët kërkojnë pjesëmarrje më të madhe në sektorin publik dhe në degën industriale, thonë se ndryshimi i praktikës së punësimit të parakonfliktit, ecën tepër ngadalë. Këta mendojnë se arsyeja kryesore është tek mungesa e përfshirjes së tyre në trajnimet profesionale, mungesa e përvojës së punës në industri (që kryesisht u dedikohet grave), niveli më i ulët i arsimimit, sidomos tek gjenerata më e vjetër (mbi 40 vjeç) dhe gjendja ekonomike e kompanive të privatizuara, të cilat e zvogëlojnë personelin e tyre të tanishëm, duke mos planifikuar punësime të reja.

Privatizimi shkaktori “ndjenjë të hidhët” të të dyja palët. Shumica e njerëzve deklaruan se “po të kishte më tepër vende pune, s’do të kishim problem me fqinjët...”

### 5.3. Potencial për rivitalizimi

Pason rezymeja e mundësive dhe pengesat për rivitalizimin ekonomik, të cilat i theksuan të intervistuarit:

---

---

## Mundësitë

- Afërsia me Serbinë dhe Kosovën, të me çka ekziston mundësia e hapur
- Potencial i madh për bujqësinë shtetërore, (klime të përshtatshme dhe tregjet e mirë, për instalimin e sistemeve të (psh. për voga për ujë)
- Kapital nga mërgimtarët, të cilët punojnë jashtë vendit (sidomos në rajonin e Kumanovës)
- Mundësia për shërbime për sidomos për krahe të biznesit me
- Diversiteti ekonomik

## Mangësitë

- Pasiguri në aspektin e zhvillimit ngjarjeve politike
- Mosbesimi te institucionet shkalla e lartë e korrupsionit
- Mungesa e mbrojtjes juridike kapitalin e investuar)
- Shkalla e lartë e kriminalitetit të organizuar në disa vise rajonet e Haraçinës dhe
- Rritja e hendekut etnik
- Rritja e shkallës së varfërisë, në rajonet rurale, që rezulton aftësi të ulët blerëse
- Varësia nga donatorët dhe vullneti i mirë i tyre
- Mungesa e strategjisë për këndellje ekonomike, mungesa e koordinimit ndërmjet subjekteve
- Infrastruktura e varfër në shumë bashkësi
- Prania e kufizuar në tregjet rajonale (sidomos në Kosovë dhe në Serbi)
- Politika restriktive e institucioneve financiare

---

Vetëm një pjesë e tyre ndërlidhen me krizën e sigurisë, ndërsa pjesa kryesore e tyre i përkasin kushteve të përgjithshme ekonomike në Maqedoninë e sotme. Rajonet rurale me shkallë të lartë jostabiliteti (komuna e Likovës), sikur të kenë më pak potencial se sa të tjerat. Duke marrë këtë rajon si shembull, parakushtet për rivitalizim *mund të definohen në këtë mënyrë:*

- Qeveria ka strategji për rivitalizim
  - Në nivelin lokal, strategjia qeveritare është bartur në fushën e rikonstruksionit dhe planit zhvillimor, pushtetit lokal i bëhet e mundur të kontribuojë për procesin e planifikimit dhe ta koordinojë implementimin
  - Prania e Qeverisë është e dukshme në bashkësi (në momentin të dukshme janë vetëm pllakat e shtruar nga donatorët, me çka fitohet përshtypja se Qeveria interesohet pak për rikonstruksionin), ndërtohet besimi te institucionet e Qeverisë
  - Është arritur një stabilitet më i madh, ka sukses në luftën kundër krimit të organizuar dhe të korrupsionit
-

- Marrëdhëniet etnike nuk janë përkeqësuar më shumë

Kemi arrdhur në përfundim se bujqësia gjithësisë, do të duhet të luajë një rol më të madh në procesin e rivitalizimit. Bujqësia është kyçe për vetushqimin në rajonet rurale, edhe për vetë zhvillimin. Mirëpo, duke marrë parasysh konkurrencën e madhe në vendet fqinj, sektori i bujqësisë në Maqedoni duhet të bëjë një hap të madh përpara, për t'u bërë konkurrues në kontekstin evropian. Kjo nuk i përket vetëm rajoneve të krizës, por tërë sektorit. Megjithatë, problemi këtu qëndron se bujqët, në ish rajonet e krizës, ende janë të shpërndarë nga zhvillimi që po ndodh në pjesët e tjera të vendit.

#### 5.4. Qasja për rivitalizim

Gjatë kohë po zhvillohet një debat nëse, dhe në çfarë mase, politika dhe ndihma për zhvillim, duhet të intervenojë në zhvillimin dhe rivitalizimin ekonomik. Vijnë në përfundim se fuqia e tregut nuk është e mjaftueshme për rivitalizimin, sidomos të atyre pjesëve, të cilat qenë goditur në mënyrë të ndjeshme nga shkatërrimet dhe që kanë potencial më të varfër ekonomik ("autondihmë"). E shohim nevojën për investime nga ana e Qeverisë dhe të donatorëve për t'u stimuluar zhvillimi i atyre bashkësive, si dhe i masave për luftë kundër rrisqeve nga pasiguria. Megjithatë, jemi të ndërgjegjshëm se:

- Sigurimi i nihmës vetëm për bashkësitë e goditura drejtpërsëdrejti, krijon disbalancim dhe anim, pasi bashkësitë fqinje, shpesh kanë probleme ekonomike të ngjashme, ose të njëjta.
- Masat e izoluara mund të rezultojnë me dështim, nëse nuk ndërlidhen me masa më të gjera, synimi i të cilave do ishte përmirësimi i gjendjes ekonomike.

## 6. REKOMANDIME

Synimi i këtyre rekomandimeve është që t'i vërë në spikamë rajonet ku duhet të investohet më tepër si dhe të bëhen përpjekje plotësuese për intensifikimin e procesit të Riintegritit dhe rivitalizimit. S'ishte e mundshme të propozohen projekte konkrete, pasi për këtë duhen diskutime të mëtejme me aksionierët e përfshirë në proces. Shembujt konkretë të disa rajoneve shërbejnë si ilustrim, si dhe për të dhënë ide fillestare.

### 6.2. Rekomandime të përgjithshme

Pushteti qendror dhe ai lokal, duhet të marrin përgjegjësi për zhvillimin e bashkësive dhe për rivitalizimin e ish rajoneve të krizës. Duhet të përcaktohen detyra të reja për subjektet në të gjitha nivelet: në nivel të pushtetit qendror, në nivel të pushtetit komunal dhe në nivel të këshillave lokale të fshatit. Kjo duhet të shqyrtohet në praninë e proceseve vijuese të rivitalizimit.

- Qeveria duhet të marrë rol aktiv si koordinatorë në raport me agjencitë ndërkombëtare; të cilat në të kaluarën, lirisht implementonin çfarëdo lloj programesh. Qeveria, gjithashtu, duhet të jetë më e dukshme nëpër bashkësi, me qëllim që ta ndërtojë besimin. Agjencitë ndërkombëtare, gjithnjë e më tepër duhet të inkuadrojnë organizata lokale për

implementimin, si dhe t'i kanalizojnë fondet e tyre përmes strukturave qeveritare dhe organizatave joqeveritare.

- Nëse pusheti lokal duhet të luajë një rol më aktiv, ekziston nevojë e ngutshme të ndërtohet kapacitet për administratat lokale që më mirë t'i përmbushin detyrat e tyre në bashkësi, si dhe për zhvillimin ekonomik. Duhet të ndërmirren këto masa:

- 
- Rritja e kapacitetit të administratës lokale për të administruar
  - Zhvillimi i kapaciteteve për planifikimin zhvillimor
  - Zhvillimi i aftësive për komunikim (administrata lokale është në situatë që të ndërmjetësojë ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit në bashkësi)
  - Rritja e kapacitetit për opinion/ kompanitë të sigurojnë shërbime sociale (ujë/satintare, mënjanimin e bërllokut, punë publike)
- 

- Mendojmë se përparësi më të madhe kanë qasjet integruese të bazuara në ndihmën e mbarë visit, karshi masave të izoluara që shtrihen në një rajon më të gjerë, për t'u arritur qasje e dukshme. Marrë në përgjithësi, ka nevojë për një koordinim më të mirë të aktiviteteve në nivelin komunal (shih më lart – roli i administratës) dhe gërshetimit të subjekteve (pushteti lokal, organizata për zhvillimin e shoqërisë civile, asociacione biznesi, asociacione bujqësore, etj). Për qasje të këtillë, parakushte janë planet zhvillimore lokale. OJQ-të, në fazat fillestare, duhet të luajnë rolin e lehtësuesit.
- Në pjesën veriperëndimore të Maqedonisë, ende ka nevojë për rikonstruksion dhe rivitalizim, duke marrë parasysh faktin se procesi i rindërtimit nuk ka përfunduar tërësisht. Kjo vlen si për rajonet e goditura drejtpërsëdrejti, ashtu edhe për rajonet e goditura në mënyrë të tërthortë. Vëmendje speciale duhet t'u kushtohet fshatrave, të cilat deri tani janë lënë pas dore dhe atyre që ia dolën ta ruajnë paqen, në vend se të kyçeshin në luftë. Duke marrë parasysh faktin se shumë probleme ekonomike në ato vise, janë të ngjashme me ato të vendit, rekomandojmë që në mënyrë graduale të zgjerohen aktivitetet në viset më pak të dëmtuara nga kriza, si dhe ndërmjet atyre më pak të zhvilluara, bashkësive të padrejtësuara.

### 6.3. Rekomandime për kthimin dhe reintegrimin

Për t'u zgjidhur problemi i radhës me të shpërngulurit brenda vendit, si duket, janë të mundshme dy opsione:

- a) Brenda disa muajve të ardhshëm të zgjidhen, sa të jetë e mundshme, më tepër raste, e pastaj personat e mbetur të sistemohen në kushte më të mira, derisa nuk vendosin të kthehen, apo t'i braktisin qendrat. Por, do mbeten në barrë të Qeverisë.
- b) Qeveria – edhe agjencitë ndërkombëtare – ta revidojnë politikën e tyre të transferimit, dhe të shpërngulurve të brendshëm t'u lihet që ata të vendosin se ku dëshirojnë të shkojnë. Ata duhet të marrin kompenzim për humbjet e tyre dhe të vendosen ku të dëshirojnë. Në këtë mënyrë, qendrat kolektive do të mbylleshin shpejt.

Zhvillimi i infrastrukturës do të duhej të kishte kujdes të veçantë, ndërsa rindërtimi i shtëpive private duhet të përfundojë deri në verën e ardhshme – siç

edhe planifikohej. Kjo përfshin infrastruktuën kyç për zhvillimin ekonomik (ujësjellës dhe deponinë e bërllokut; telekomunikimet) dhe infrastrukturën sociale sipas nevojave prioritare. Parim prijës për të gjitha intervenimet duhet të jetë kontributi adekuat nga ana e bashkësisë, si dhe kapaciteti i vetë bashkësisë që në mënyrë afatgjatë të operojë me sistemet.

Fokusi i këtij studimi është që për banorët e ish rajoneve të krizës, pajtimi dhe (ri)integrimi janë tema me rëndësi të posaçme për tërë vendin. Prandaj, rekomandimet vijuese nuk u dedikohen vetëm viseve veriperëndimore:

Si duket shoqëria maqedonase po kalon nëpër procesin e ndarjes ndërmjet dy grupeve etnike dhe, në këtë moment, askush nuk është në gjendje ta ndërpresë këtë tendencë. Prandaj, ka nevojë për konceptin integruar me qëllim që të mundësohet dialogu dhe mirëkuptimi ndërmjet grupeve etnike. Duhet të forcohen faktorët e afrimit, dhe të zvogëlohen faktorët e ndarjes.

Kështuqë, integrimi etnik duhet të konsiderohet si çështje kryesore, që duhet të mirret parasysh në të gjitha nivelet dhe në të gjitha llojet e aktiviteteve. Synimi i ideve vijuese është vetëm të orientojnë, e mund të formësohet një numër i madh aktiviteteve të ndryshme. Ato duhet të zhvillohen me kreativitet, duke marrë parasysh çdo grup dhe çdo situatë të veçantë:

Të identifikohen ose të forcohen programet e pajtimit për menaxhimin me stereotipet ndëretnike dhe akuzave reciproke, se ai tjetri është fajtor për krizën, kërcënimin /diskriminim, jогatishmërinë për bashkëpunim etj.

Aktivitete/masa të mundshme:

- Të rinjve duhet t'u jepet shansi që jashtë shkollës të takohen në një kontekst të paanshëm. T'u mundësohet miqësimi me të rinjtë e grupit tjetër. Si motivim për këtë mund të shërbejnë aktivitetet interesante nga fusha e kulturës dhe sportit etj.
- Të zgjidhen problemet e ish luftëtarëve, me masa të ndryshme, që s'do të thotë gjithmonë edhe punësim në administratën publike. Integrimi i tyre në shoqëri, do të mund të promovohet përmes masave, siç janë kurset për kualifikime.
- Familjeve, të cilat kanë humbur ndonjë anëtar të tyre në konflikt, ose është zhdukur, t'u mundësohet këshillimi, që do t'u jepte shans të orientojnë për të ardhmen e tyre, e jo të jetojnë me të kaluarën.
- Me të rriturit, ku paragjykimet kanë lëshuar rrënjë të thella, komunat duhet të zhvillojnë programe të një natyre tjetër, siç janë programet e shkëmbimit midis fshatrave.
- Disa punë në bashkësi, për të cilat kërkohet komunikim ndëretnik, siç janë sistemet e ujësjellësve dhe sanitare, mënjanimi i bërllokut ose aktivitetet zjarrfikëse, duhet të shfrytëzohen në mënyrë sistematike për t'u përmirësuar komunikimi dhe bashkëpunimi.

Duhet të zhvillohen koncepte për integrimin në frymën e përcaktimeve të Marrëveshjes Kornizë, që të përmirësohet komunikimi publik dhe personal, dhe në këtë mënyrë, të kompenzohen tendencat për ndarje të mëtejme të shoqërisë.

---

Aktivitet/masa të mundshme:

- Të përkrahen paralelet e përziera etnike në arsimimin informal dhe në programet për trajnim, sidomos në sferën/temat/ që i bashkojnë orientimet profesionale, zhvillimin e shkathtësive dhe çështjet e përgjithshme evropiane.
- Në arsim, t'u ligjërohet një histori të gjithë grupeve etnike. Kështuqë, tekstet në të dy gjuhët duhet të flasin për një histori për vendin e tyre.
- Më tutje, ka nevojë për programe që nxënëseve të të gjitha grupeve etnike t'u mundësohet të takohen lirshëm, të komunikojnë dhe të bashkëpunojnë.
- Duhet punuar edhe në rrjedhën e informatave në mes të grupeve kryesore etnike, sidomos lidhur me temat që i afrojnë bizneset, problemet e përbashkëta komunale (infrastruktura) dhe qasje te infromatat për ndihmë.

Të fuqizohet vetëdija e opinionit, si preventivë e manipulimeve të partive politike dhe të grupeve të tjera të interesit, të orientuara drejt synimeve afatshkurta.

Aktivitet/masa të mundshme:

- Të zhvillohen programe të caktuara mediumesh, duke e ndjekur me kujdes atë që publikohet / përmbajtjen e emituar dhe demantin e regullt dhe të pavarur për të pavërtetën.
- Ata që e ndërtojnë mendimin e opinionit duhet të takohen shpesh lidhur me konceptet pozitive. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar politikanëve të rinj, liderëve të OJQ-ve, biznes liderëve, personave të tjerë publikë /aktorë, muzikantë etj).
- Fushatat për ngritjen e vetëdijes publike, llogariten si të domosdoshme që të demonstron siguria e përmirësuar, liria e lëvizjes (udhëtimi, komunikimi), demonstrimi i bizneseve të sukseshëm në viset me konflikt.

Duhet të trimërohet potenciali i femrës për koegzistencë paqesore ndërmjet grupeve etnike. Gratë duhet të luajnë një rol më të madh në jetën sociale të fshatit. Duhet të përkrahen aktivitetet, siç janë themelimi i klubeve sociale dhe aktivitetet të ndërlidhura me fëmijët, si dhe programet për mbështetjen e bashkëpunimit ndërmjet grave të grupeve të ndryshme etnike.

Masa të tjera speciale mund të jenë programet me këtë synim:

- Përmirësimi i afërsive të grave për të gjetur punë:
  - Seminarë për orinetim pune, arsimimi i të rriturve, trajnimi i shkathtësive (për gratë pa përvojë dhe pa punë)
  - Mundësimi i trajnimit dhe mbindërtimit profesional për gratë e papunësuar (psh. kurse profesionale për gratë menaxhere biznesi)
- Përmirësimi i aftësive të grave që të garojnë në sektorin e biznesit (trajnim për sipërmarrëse, mbështetje biznesi dedikuar grave, psh. këshilla afariste për gratë në të dyja gjuhët)

Të rritet kujdesi publik për të rinjtë, dhe me këtë të mënjanohet përjashtimi social, manipulimi dhe sjellja antisociale e tyre.

---

Aktivite/masa të mundshme:

- Të ftohen të shpërgulurit e brendshëm, të tanishmit dhe të mëparshmit, që të marrin pjesë në aktivitetet e pajtimit, si dhe në aktivitetet e përbashkëta kulturore, sportive etj.
- Të ftohen ish luftëtarët (rezervistë ushtrie dhe policie/ish guerilasit - të jenë të pranishëm në aktivitetet e pajtimit, në kurset për orientim profesional, kurset për zhvillimin e kualifikimit
- Të rinjve të papunë nga rajonet e krizës, t'u ofrohen kurse për orientim profesional, si dhe kurse për zhvillimin e kualifikimit

#### 6.4. Rekomandime për rivitalizimin ekonomik

Gjatë dy vjetëve të kaluara, Qeveria dhe donatorët ndërkombëtarë, u përqëndruan kryesisht në rikonstruksionin e shtëpive private dhe të infrastrukturës, ndërsa ndërtimi i bazës ekonomike për banorët, pati një përkujdesje të pamjaftueshme. Duke marrë parasysh se papunësia gjithnjë e më e madhe dhe varfëria, janë dy probleme kryesorë për të gjithë banorët e Maqedonisë dhe faktorë kyç për stabilitetin, propozojmë kujdes prioritar t'i kushtohet zhvillimit dhe rivitalizimit ekonomik.

Thelbësorja e rivitalizimit dhe zhvillimit të ekonomisë lokale është:

- Të ndërmerren masa për rehabilitimin e ambientit të volitshëm për biznes, psh:
  - Përmirësimi i sigurimit juridik i sipërmarrësit
  - Rehabilitimi i infrastrukturës që është vitale për aktivitetet ekonomike
  - zhvillimi i strategjive zhvillimore lokale që e trimërojnë biznesin
- Të promovohet konkurrenca ndërmjet firmave
- Për afat më të gjatë: Të krijohen mundësi për investime të reja, pa marrë parasysh nëse janë të jashtme, apo lokale. Parimi themelor i kësaj qasjeje është inkuadrimi i subjekteve kyç (Sektori i biznesit i prezantuar përmes shoqatave, administratës lokale/ komuna dhe institucione në përkrahje të biznesit) në procesin e planifikimit dhe implementimit si dhe bashkëpunimi i tyre i ngushtë.

Në këtë drejtim rekomandojmë:

- Të ndërmerren masa për ndërtimin e vetëdijes për fillimin e procesve lokale për zhvillim ekonomik në nivele komunale për 2/3 e komunave. Investuesit/facilitatorët duhet të jenë organizata neutrale – psh. OJQ, të cilat kanë qasje te të gjitha subjektet kyç.
  - Mundësimi i zhvillimit të agjendave lokale / plane strategjike, me pjesëmarrjen e subjekteve kyç dhe ndërtimi i kapaciteteve për implementim, pra, ndërtimi i kapaciteteve, sidomos në administratën lokale, kurse shoqatat të kenë rol aktiv dhe efikas.
  - Masa për rivitalizimin e ekonomisë lokale, me programe nacionale për zhvillimin ekonomik për t'u krijuar shoqata dhe për t'u siguruar pjesëmarrje lokale organeve nacionalë.
  - Të flaket logjika e “projekteve me rezultate të shpejta” dhe fokusi të bartet mbi rivitalizimin dhe stabilizimin afatgjatë.
-

- Të përmirësohet koordinimi dhe gërshetimi ndërmjet iniciativave për zhvillim të biznesit në nivel lokal (të krijohen panel grupe koordinative, nacionale dhe lokale).

Bujqësia është baza kryesore për jetën e njerëzve, të cilët jetojnë në rajonet e goditura nga konflikti. Pastaj, sektori bujqësor, edhe pse ngel prapa standardeve evropiane, ka potencial për zhvillim ekonomik. Prandaj, rekomandojmë që sektori bujqësor ta gëzojë kujdesin prioritar gjatë rehabilitimit.

a) Në nivel ekzistence:

- Të ndërmerren masa për rikthimin e prodhimeve bujqësore të këtyre familjeve, të cilat qenë goditur seriozisht nga kriza (psh. përmes sigurimit të huave ose ndihmës materiale /grante gjatë fazës fillestare).

b) Në nivel afarist:

- Promovimi i nënsektorëve me potencial rritjeje
- Fokusi për masat e marketingut (psh. sigurimi i cilësisë, paqetimi, forcimi i kapaciteteve për pjesëmarrje në ekonominë rajonale)
- Promovimi i shoqatave bujqësore lokale, ndërtimi i kapacitetit të këtyre organizatave
- Ndërtimi i kapacitetit i shërbimeve profesionale adekuate

Me urgjencë duhet të ndërmerren masa që të përmirësohet – në mbarë rajonin e krizës (20) – *qasja e njerëzve tek shërbimet e biznesit financiar dhe jofinanciar.*

Aktivitete /masa të mundshme:

- Të promovohen fonde grante për rrisqe politike dhe kolaterale (është e nevojshme syçeltësia për të mos u larguar nga parimet e tregut gjatë promovimit të biznesit!)
- Për periudhën e tranzicionit të krijohet nxitje për sektorin bankar, që të inkuadrohet në viset e goditura nga konflikti (subvencione për personel plotësues).
- Të përmirësohet qasja tek masat jofinancuese për përkrahjen e biznesit për grupet pakica, psh., përmes:
  - Sigurimit të qasjes së barabartë të informatat (informatat të botohen në dy gjuhët kryesore)
  - Trajnimi në gjuhën shqipe ose këshilltarët në dy të gjuhët
  - Botimi i doracakëve në të dy gjuhët.

Biznesi të luajë rol në forcimin e marrëdhënieve ndëretnike (biznesi si faktor i "lidhjeve"). Ndër idetë kryesore janë:

Aktivitete/masa të mundshme:

- Promovimi i lidhjeve të biznesit ndëretnik
- Promovimi i tregjeve regjionale (Kosovë, Serbi)

-----

(20) Kjo i përfshin edhe fshatrat e goditur direkt, edhe ato indirekt.